

Libri i librave

Të lexosh do të thotë të kërkosh

Zëri i shpresës

Të lexosh me ëndje fjalën më supreme

Islami mes dijes dhe praktikës

Letërsia dhe artet në Islam

Ndjekja e sunnetit, detyrë për çdo musliman



*Lexo në emër
të Zotit tënd*



EDITORIAL


Shtetet në të cilat nuk zhvillohen masat e intelektualëve dhe lexuesve të rregullt janë të destinuara të shkojnë së prapthi, jo të ecin përpara, sepse njerëzit e zhveshur nga dashuria dhe pasioni për librin kthehen në skllëvër të dashurisë për materien. Këta mashtrohen lehtë nga të mirat materiale dhe ata që i përdorin ato qoftë edhe në dëm të tyre sepse nuk arrijnë të lexojnë dhe të meditojnë shumë, si dhe nuk arrijnë të kenë një kritikë të pastër përtej informacionit të thatë dhe opinionit të lehtë që arrijnë në sajë të leximeve të sipërfaqshme.

Në shtetet ku ka shumë intelektualë dhe lexues të kulturuar në masë kalohet në lëvizje për ti përmisuar mangësitë që po përjeton vendi, kërkohen sa më shpejt reforma në këto drejtime, që gjë nuk ndodh në shtetet e pazhvilluara që sa shkojnë e fundosen më shumë në kaos. Në fund fare shtete me një të kaluar të ndritshme janë shkatërruar për shkak të këtyre sefih.

Ajo që sot shumë shtete të botës muslimane duhet të zgjidhin është të gjej rrugët që brenda sistemit arsimor që fillon nga fillorja dhe përfundon me diplomën e universitetit ti mësojë nxënësve shprehinë e të lexuarit dhe ti bëjë që ta fitojnë këtë aftësi. Tu japësh nxënësve këtë shprehje nuk është edhe aq e vështirë. Përkundrazi, është shumë e lehtë.

Ne myslimanët mund ti bëjmë të rinjtë tanë që të lexojnë më shumë libra duke u kthyer në vlerat që na përkasin neve.

Poqese rinia muslimane ka hyrë në mijëvjeçarin e shekullit të XXI pa librin, e ardhmja e prosperitetit dhe zhvillimit si bashkësi fetare është në rrezik. Kjo do të thotë se jemi të destinuar të jemi rrënjët e neo-imperializmit dhe të mbetemi robërit e imperializmit të brendshëm.





NË KËTË NUMËR DO TË LEXOINI:

4



LIBRI I LIBRAVE

EDISON ÇERAJ

4

TË HYSH NË MIJËVJEÇARIN E RI PA LIBËR

XHEMAL AJDËN

6

LIBRAT NUK LEXOHEN
VETËM NË KOHË TË LIRË

ALI BYJYÇAPAR

9

NDALESË MES DY VITEVE
PËR LLOGARITJEN E VETES

DR. JUSUF EL-KARDAVI

10

TË LEXOSSH DO TË THOTË TË KËRKOSH

IDRIS ARPAT

12



12

MBI LEXIMIN

SHERIF BENEKÇI

16

ZËRI I SHPRESËS

ELONA VISHA

17

PSE HAXHI?!

HAMDI NUHIJU

18

NJERIU I TURMËS

BRAHIM RAMJA

20

18



Nëntor - Dhjetor 2009

ISLAMI MES DIJES DHE PRAKTIKËS

NAIM DRIJAJ

24

MANIA SI DOMOSDOSHMËRI

EVANS DRISHTI

26

AJETE DHE HADITHE

30

TË LEXOSH ME ËNDJE FJALËN MË SUPREME

OSMAN NURI TOPBASH

32

KU JANË TRETUR NXËNËSIT E ULEMASË SË SOTME?

NEXHAT IBRAHIMI

38

LETËRSIA DHE ARTET NË ISLAM

SEJJID HUSEJN NASR

42

NDJEKJA E SUNNETIT,
DETYRË PËR ÇDO MUSLIMAN

ANDËRSON MARKU

48

VAKËFNAMEJA E SHEJH MAGRIBIUT


RELIKTE HISTORIKE

50

32



42



48



Viti: III Numri: 21

- Nëntor - Dhjetor 2009
- Dhulkade - Dhulhixhe 1430

Boton

- Progresi sh.p.k.
- Shkodër / Shqipëri

Përkthyes

- Arjan Ymeri
- Ermal Nurja
- Evans Drishti
- Fatmir Sulaj
- Ilir Hoxha
- Ilir Rruga

Redaktor

- Islam Dizdari

Dizenjo - Grafik

- Bledar Xama
- bledar_xama@hotmail.com

Ngjyra

- Progresi

Adresa

- L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi
- Shkodër
- Tel: +355 22 254 534
- Fax: +355 22 254 533
- Cel: +355 20 76768 / +355 20 86767

Shtyp

- ArbëriaDesign, Tetovë
- Tel: +389 44 35 33 71
- Fax: +389 44 35 33 72

Për artikuj

- e-mail: revistaetika@progresibotime.com
- e-mail: kosova@progresibotime.com

Çmimi

- 1 Euro
- 150 Lek
- 60 DEN





Libri i Librave

Le ta themi që në kryeherë se libri i librave është Kurani. Mund të tingëllojë radikal ky pohim, aq më tepër në këtë kohë ku qytetërimi ynë materialist është më i gazmendur se kurrë ndonjëherë më parë, që sipas të cilit nuk ka asnjë të vërtetë absolute: Çdo gjë varet, por ky pohim nuk është gjë tjetër vetëm se bindja e njëmendtë e të gjithë atyre që e besojnë këtë libër bashkë me librat e tjerë para tij. Kurani duke qenë i qartë dhe i prerë në atë që kumton, duke mos lënë asnjë tis dyshimi për atë që njëmend kërkon të udhëzohet përmes tij, e sfidoi dhe vazhdon ta sfidojë njerëzimin për të bërë një të barabartë me të (Kurani, 10-38; 28-49); por, Zoti duke qenë i gjithëditur për paaftësinë e njeriut e zbriti këtë sfidë

në dhjetë sure ose kapituj (Kurani, 11-13), ndërsa më pas në një kapitull të vetëm (Kurani, 2-23), e në fund vetëm në disa vargje (Kurani, 52-33). Kështu duke dalë pakrahasimisht më superior se çdo inteligjencë njerëzore, Kurani shpalli mrekullinë e tij dhe njëherësh paaftësinë njerëzore duke e nxitur edhe më shumë ngasjen, se, edhe nëse mblidhen sëbashku me njerëzit edhe xhinët nuk kanë për t'ia dalë kurrë që të bëjnë qoftë edhe një ajet të vetëm (Kurani, 17-88). Çdo libër i dalë nga dora e njeriut nuk është gjë tjetër vetëm se gjakim i pavetëdijshëm për të sjellë në jetë një vepër e cila të përthithë e të mbërthejë të gjitha shikimet, thënë ndryshe një libër udhërrëfyes, pasi nuk ka asnjë autor që sado i përunjur të jetë që të mos dojë që vepra e tij të jetë në qendër të vëmendjes,

por siç edhe e dimë fort mirë, një gjë e tillë nuk ka ndodhur dhe nuk do të ndodhë. Nuk ekziston asnjë libër që të mund të jetohej sipas tij. Askush nuk mund të jetojë sipas Platonit ose Kantit, Homerit apo Shekspirit, pavarësisht se këta filozofë dhe poetë kanë lënë një trashëgimi të pashlyeshme për pasardhësit, prapëseprap nuk kanë lënë një *modus vivendi*, një shembull të prekshëm se si duhet të jetohej.

“Shumë kohë përpara Profetit - paqja qoftë mbi të -, arabët e kishin përsosur artin e tyre letrar dhe kishin arritur shkëlqim të veçantë në të. Aftësia e tyre për të prodhuar vepra me vlera të mëdha letrare ishte e pakrahasueshme me çdo kulturë tjetër. Historia nuk njih popull tjetër, tek i cili fjala dhe bukuria e saj të kishte po kaq rëndësi. Për arabët, bota ishte çështje jete

dhe vdekjeje, harrese dhe përjetësie, lufte dhe paqeje, virtyti dhe vesi, fisnikërie dhe rëndomtësie.

"*Ixhaz*" është emri që i është dhënë dukurisë së Kuranit për t'i sfiduar të gjithë njerëzit në të gjitha kohërat, por veçanërisht bashkëkohësit arabë të Profetit, për të bërë një vepër që të ishte e barabartë me të në bukuri e përsosmëri. Ai përmban dy elemente: i pari është karakteri prej natyre i Kuranit, i cili, kur perceptohet prej mendjes së aftë për ta perceptuar atë, shkakton ndienjën e mahnitjes, të të qenit i prekur, të të ndierit të vlerave më të larta e më të thella, shkurt, të përballjes së realitetit fatfundësor me të gjitha përvojat shoqëruese për një përballje të tillë. E dyta është të kuptuarit e dallimit që ndan njeriun, perceptuesin, nga Zoti, i perceptuari, një tregues i të cilit është paaftësia e njeriut për të bërë diçka të ngjashme me Kuranin. E para është prej natyre për Kuranin, e dyta për njeriun. Arabët të dytës i thonë thjesht "*ixhaz*", dukuri apo ngjarje e të mrekullueshmes; kurse të parën e quajnë "*vuxhuh el ixhaz*" apo aspekte të mrekullisë së Kuranit". (Ismail Faruki)

Nëse letërsia si fusha më e epërme që ka arritur njeriu me fjalën e shkruar, përmes ngjarjes na zbulon rregullin, Kurani përmes rregullit përcakton ngjarjen, pra çdo që i duhet të dijë njeriu për të ndërmarrë pozicionin e duhur.

Sfida që Kurani i ka bërë dhe i bën njeriut, në fakt nuk njih kohë, por është gjithnjë e vazhdueshme. Një dëshmi e dukshme për këtë është forca e Kuranit për t'ua ndryshuar jetën njerëzve duke pranuar Islam, për t'i bindur ata menjëherë për prejardhjen hyjnore qoftë të tij qoftë të tyre, sepse në thelb njeriu mbetet një qenie thellësisht religjioze, pavarësisht harresave që mund ta kapullojnë atë përgjatë rrugëtimit jetësor. Nuk ka njeri që të lexojë atë që muslimanët kanë shkruar në lidhje me përvojën e tyre me Kuranin, apo që pikas ndikimin e Kuranit mbi ndërgjegjen, jetën dhe mendimet e tyre, dhe të mund të shmangë përfundimin se Kurani është fjala e Zotit zbuluar Profetit Muhamed - paqja

qoftë mbi të.

Në të vërtetë, qëllimi i Kuranit dhe i çdo zbuluese para tij, nuk është sfida ndaj njeriut, përkundrazi, Kurani është shpërfaqje e madhërishme drejtuar njeriut për të kuptuar jetën dhe ekzistencën duke u ndihur pikërisht nga dituria e pamatë e Atij që dhuntoi çdo ekzistencë, ndërkohe që s'ekzistonte absolutisht asgjë. Muslimanët besojnë që Zoti është i vetmi burim epistemologjik, që përmes Zbulesës i mundësoi njeriut të kuptonte mungesën e çdo rastesie rreth krijimit të jetës, ndërsa nga ana tjetër, duke patur parasysh këtë, mundshmërinë e çdo rastesie - sidomos në trajtën e mitit, legjendës, përrallës etj. - nëse si burim epistemologjik merret një autoritet tjetër veç Zotit. Kurani i jep njeriut aq dituri sa është e mjaftueshme për të njohur Zotin dhe të Dërguarin e Tij, e më pas me anë të kësaj diturie ai është i gatshëm ta farkëtojë këtë botë në kuptim dhe në formë, pasi kjo botë nuk është "mbretëria e djallit", siç besojnë të krishterët, porse një realitet i pashmangshëm për të humbur ose për të fituar botën tjetër - dhe si e tillë e paanashkalueshme. Pra, në këtë pikë hasim një veçori tjetër të Kuranit, që në fakt nuk gjendet te librat e tjerë, që është të qenurit burim i përhershëm njohurie (epistemologjik) për njeriun. Vetë fjala *njohje* nënkupton të kutposh ose të qartësohesh për një gjë për të cilën nuk mjafton forca e shqisave për ta kuptuar, që pak a shumë i bie të jetë metafizika, gjithnjë sipas kënvështrimit të filozofisë perëndimore, që Kurani e përshenjon me fjalën *gajb*. E gjithë sa më sipër, nënkupton që njeriu nuk mund ta njohë Zotin dhe asgjë tjetër përtejësore (në kutpimin e pamundësisë së arsyes dhe shqisave për ta kapur), vetëmse duke iu drejtuar fjalës së Zotit, dija e të cilit nuk njih kufij, dhe siç u përmend edhe më lart, i jep njeriut aq dituri sa ç'është e nevojshme për të kuptuar atë që i duhet të kuptojë, pasi fatkeqësisht një problem tjetër i njeriut modern është se nuk e di edhe se çfarë duhet të kuptojë! Edhe në këtë pikë Kurani e ka dhënë zgjidhjen, madje që në vargjet e para hyrëse: "Çdo

lavdërim i përket Allahut, Zotit të botëve, të Gjithëshmshirshmit, Mëshireplotit, Sunduesit të ditës së Gjykimit. Vetëm Ty të adhurojmë dhe vetëm prej Teje ndihmë kërkojmë. Udhëzoni në rrugën e drejtë! (El-Fatiha, 1-5)

Kurani në mënyrë tejet mbresëlënëse i ofron çdocilit atë që i duhet dhe sidomos aq sa i duhet, duke iu drejtuar thjeshtë "atyre që mendojnë", pra intelektit. Çdokush mund të gjejë atë që kërkon në këtë libër, mrekullitë e të cilit nuk kanë të sosur, pavarësisht besimit, gjinisë, moshës, kombësisë apo ndonjë dallimi tjetër, pasi kumti kuranor është i gjithëbotshëm.

Një tjetër veçori e këtij libri është se, ndryshe nga profetët e hershëm, profetësia dhe zbulesat e të cilëve u ngritën përmes thyerjeve të ligjeve të natyrës (d.m.th. përmes kapërcimit të fuqive epistemike të vetëdijes njerëzore), Kurani ua paraqiste "mrekullinë" e tij vetë atyre fuqive që ishin të afta ta kuptonin atë dhe i ftonte ato që ta vlerësonin dhe ta pohonin me kujdes këtë mrekulli apo prejardhjen e tij hyjnore. Thirrja e tij i drejtohej të menduarit dhe të arsyetuarit si dy entitete qenësore të njeriut. Ndërsa zbulesat e tjera e "shtrëngonin" ndërgjegjen përmes thyerjeve të ligjit të natyrës nga ana e tyre, Kurani e bindte atë përmes përmbushjes së asaj çka arsyeja më së tepërmi priste të përmbushej. Kjo është arsyeja se pse natyra e mrekullueshme e Kuranit u bë subjekt studimi dhe analize nga shumë e shumë studiues, por natyrisht edhe nga njerëz të thjeshtë. Një mrekulli fizike si e Moisiut apo e Jezusit thjesht i trondiste shikuesit. Një mrekulli e tyre ishte, për nga natyra e saj, përtej arsyetimit dhe përtej diskutimit. Kurani troket tek arsyeja e njeriut, pra është pranë njeriut, madje më pranë se ç'mund të imagjinohet. Çdo arsyetim të shpie te ky përfundim, ndërsa refuzimi vetëm e mbulon këtë realitet, por nuk e shmang dot: ky është thelbi i mosbesimit, ilaçi i të cilit besoj që sapo është treguar: thjeshtë duhet pak guxim për ta përdorur.

Të hysh në mijëvjeçarin e ri pa libër



*Asgjë nuk realizohet, në qoftë se më
përpara nuk besohet në emergjencën dhe
nevojën e leximit të librit.*



Po e filloj nga kjo e dhënë. Popullsia e Francës është 10 milion banorë më pak sesa e Turqisë. Përballë këtij fakti qëndron e dhëna tjetër se numri i librave që blihen dhe lexohen nga francezët brenda një viti e kalon shifrën 10 milion. Sasia e librave që blihen dhe lexohen nga turqit nuk mbërrin as një të dhjetën e shifrës së librave të lexuar nga francezët.

Në numrin e saj të datës 24 qershor 1994 gazeta Le Monde jepte një listë jo të gjithë librave, por të një pjese prej

tyre që janë shitur brenda një viti në Francë. Po të lëmë mënjane botimet e universiteteve dhe institucioneve zyrtare, do të shihet se numri i librave që hedh në treg sipërmarrja private e botuesve e kap shumë lehtë shifrën prej 10 milion kopjesh.

Po të shohim këtë listë në të cilën shumë libra shiten me një tirash prej qindra mijërash do të shohim se francezët më shume sesa romanet rozë dhe policesk preferojnë të lexojnë romane serioze me vlera letrare, romane që kanë prirje drejt ngjarjeve historike apo që mbartin natyrë dokumentare,

si dhe libra nga jeta e politikës dhe e mendimit.

Në këtë listë të përgatitur nga gazeta Le Monde nuk është regjistruar asnjë libër me tematikë fetare, me përjashtim të një libri të papatit. As që i përmendet emri ndonjë libri me poezi. Po ti shtojmë këtë dhe lloje të ngjashme të librave mund të jemi të sigurt se tirazhi i librave të shitur në këtë vend e kap madje edhe shifrën 15 milion.

Përshtypja që kam nga emrat e librave, numri i shitur dhe lloji i tij më bën të mendoj se francezët i japin rëndësi veprave serioze dhe nuk

kanë shumë interes për veprat aventureske.

PËRSE LEXOJNË?

Shprehia e të lexuarit mund ti jepet njerëzve shumë mirë në vitet e shkollës. Ngaqë ka një traditë të vjetër që e njeh rëndësinë e kësaj të vërtete Ministria Franceze e Arsimit harton programe serioze dhe të mbështetura mbi studime pedagogjike në drejtim të nxitjes së të rinjve që ata të fitojnë shprehinë e të lexuarit. Një nxënës i diplomuar nga një lice francez është i detyruar në sajë të këtyre programeve që të ketë lexuar me qindra vepra të mendimit dhe romane serioze letrare përveç librave të shkollës. Ai që nuk e realizon këtë gjë nuk diplomohet.

Për fat të keq në vendet tona jo një student i gjimnazit, por edhe një student i universitetit mund të diplomohet nga universiteti dhe përveç librave të shkollës mund të mos ketë lexuar edhe një libër të vetëm. Dhe këta nuk janë të paktë. Pasi që sistemi arsimor është ndërtuar në mënyrën që edhe po të mos lexosh mund të diplomohesh.

Numri i intelektualëve dhe lexuesve të rregullt të librit tregon edhe nivelin e një vendi. Asnjëherë nuk ka qenë e mjaftueshme të kesh disa mendimtarë dhe intelektualë të mirëfilltë.

Kriteri i vërtetë ndërmjet shteteve të përparuara dhe atyre të prapambetura është emergjenca e shumë intelektualëve të mirëfilltë dhe më shumë se kjo nevoja e krijimit



të një mase që është e aftë ti kuptojnë ato që thonë apo shkruajnë këta intelektualë, e një turme që kupton ato që i thuhën. Në vendet e zhvilluara ekzistojnë edhe intelektualët e shumtë me kapacitete të llojllojshme, edhe një masë lexuesish të kulturuar që arrijnë ti ndjekin ata gjatë punës së tyre intelektuale. Ndërsa në vendet e prapambetura ekziston një masë lexuesish-intelektualë në numër të vogël.

Arsyeja që mora si shembull Francën, është fakti i thjeshtë se mua më ra në dorë një e dhënë në lidhje me të, por nuk kam dyshim se po të kisha të dhëna edhe për shtetet e tjera të Evropës nuk do të habitesha poqese do të kuptoja se numri i lexuesve në këto vende nuk është i vogël, përkundrazi është shumë më i lartë.

AI QË NUK KA DURIM TË LEXOJË, NUK DI TË MENDOJË THELLË

Shtetet në të cilat nuk zhvillohen masat e intelektualëve dhe lexuesve të rregullt janë të destinuara të shkojnë së prapthi, jo të ecin përpara, sepse njerëzit e zhveshur nga dashuria dhe pasioni për librin kthehen në skllëvër të dashurisë për materien. Këta mashtrohen lehtë nga të mirat materiale dhe ata që i përdorin ato qoftë edhe në dëm të tyre sepse nuk arrijnë të lexojnë dhe të meditojnë shumë, si dhe nuk arrijnë të kenë një kritikë të pastër përtej informacionit të thatë dhe opinionit të lehtë që arrijnë në sajë të leximeve të sipërfaqshme.

Synimi i vetëm i atyre që nuk lexojnë, si rezultat edhe nuk mendojnë është zotërimi i pasurive të shumta, të cilat ata kërkoj-



pazhvilluara që sa shkojnë e fundosen më shumë në kaos. Në fund fare shtete me një të kaluar të ndritshme janë shkatërruar për shkak të tyre.

Ajo që sot shumë shtete të botës muslimane duhet të zgjidhin është të gjej rrugët që brenda sistemit arsimor që fillon nga fillorja dhe përfundon me diplomën e universitetit ti mësojë nxënësve shprehinë e të lexuarit dhe ti bëjë që ta fitojnë këtë aftësi. Tu japësh nxënësve këtë shprehje nuk është edhe aq e vështirë. Përkundrazi, është shumë e lehtë. Ajo e cila konsiston në sistemin arsimor francez është hartimi i atillë i testeve dhe pyetjeve të provimeve në mënyrë që nxënësit të mos dinë ti zgjidhin poqese nuk i kanë lexuar librat që u janë kërkuar të lexohen më parë.

në ti fitojnë me rrugë të ndryshme, çfarëdo qofshin ato (pa dalluar haram apo hallall, duke ia shkelur të drejtat të tjerëve pa u shqetësuar për këtë gjë, duke mos iu shmangur edhe rrugëve të mashtrimit dhe matrapazllëqeve), sepse në fund dëshirojnë të mburren me to.

Në një shoqëri të mbushur me individë të tillë nuk din të marr fund ryshfeti, keqpërdorimi, diferencimet e padrejta, fitimi i parave duke përdorur postin etj. Çdo gjë mund të blihet me para. Njerëzit e ndershme, të rregullt dhe profesionistët mbesin përherë në plan të fundit. Populli nuk e ndjen më nevojën që ti gjykojë drejtuesit e tij. Me kalimin e kohës njerëzit personaliteti i të cilëve nuk është pjekur ende fillojnë të mendojnë se për të pasur poste dhe para duhet të jesh mashtrues, të bësh dallavere, të vjedhësh dhe se duhet ti mashtrosh njerëzit.

Duartrokiten me të madhe personat që zhvatin burimet financiare të shtetit, më shumë duartrokiten ata që vjedhin më shumë.

Në këtë shoqëri nuk mund të gjesh drejtues, politikan apo pardon që ti vijë turp kur të dalin në shesh paratë e shtetit apo të popullit që i ka ngrënë pa të drejtë. Përkundrazi, turmat e lëna injorante iu krehin bishtin dhe i mbështesin ata.

NEO-IMPERIALIZMI

Shkurtimisht, në shtete e përparuara ndodh e kundërta e atyre që ngajnë në shtetet e pazhvilluara.

Në shtetet ku ka shumë intelektualë dhe lexues të kulturuar në masë kalohet në lëvizje për ti përmisuar mangësitë që po përjeton vendi, kërkohen sa më shpejt reforma në këto drejtime, që gjë nuk ndodh në shtetet e

Ne myslimanët mund ti bëjmë të rinjtë tanë që të lexojnë më shumë libra duke u kthyer në vlerat që na përkasin neve.

Por asgjë nuk realizohet, në qoftë se më përpara nuk besohet në emergjencën dhe nevojën e leximit të librit. Si mundet tua shpjegojë masave këtë të vërtetë drejtuesi që nuk lexon libra dhe nuk i ndjek nga afër botimet e reja që dalin? Këtu qëndron i gjithë problemi.

Poqese rinia muslimane ka hyrë në mijëvjeçarën e shekullit të XXI pa librin, e ardhmja e prosperitetit dhe zhvillimit si bashkësi fetare është në rrezik. Kjo do të thotë se jemi të destinuar të jemi rrënjët e neo-imperializmit dhe të mbetemi robërit e imperializmit të brendshëm.

Librat nuk lexohen vetëm në kohë të lirë.



*K*oha është enigmë. Faktori më i madh që bën që mos të zbërthet kjo enigmë e cila ka nevojë të kuptohet dhe të shprehet përmes simboleve është realiteti i marrëdhënies që ka krijuar çdo gjallesë me të.

Urtësia hyjnore e ka mbajtur kohën larg mosbesimit dhe mallkimit, gjë në të cilën qëndron e fshehur një enigmë tjetër. Mijëvjeçari ynë i ka dhënë një rëndësi të madhe kohës së nevojës së shumëfishimit të kulturave të epokave të ndryshme. Qytetërimi ynë i formoi gati të gjithë mundësitë që i ofronte botës në tërësi mbi konceptin e lëvizjes (kinea) duke na detyruar qoftë edhe me pahir t'ua dimë vlerën edhe sekondave që kalojnë.

Libri shpalos para nesh fletët e kohës absolute, duke bërë që në të vërtetë me çdo libër që marrim në dorë që ta lexojmë të kapemi fort pas kohës absolute. Sa inter-

esante është që në të njëjtat fletë të jenë vendosur brenda së sotmes edhe momentet që i përkasin të djeshmes dhe së nesërmes. Kjo ngjan me dukurinë fizike kur shtatë ngjyrat e diellit të mbeten të fshehura në dritë të bardhë.

Deri më sot kemi dëgjuar shpesh herë që procesi i leximit të librave të shpjegohet si një vlerësim që i bëhet kohës së lirë që kemi, por si për ironi librat që kemi në dorë na mësojnë se kjo nuk është aspak ashtu siç na është thënë deri tani. Kur i hedhim një sy përmbajtjes së librave kuptojmë se për ne është e domosdoshme që leximi i librave të zërë jo thjesht një pjesë nga koha e lirë që kemi, por një orar të caktuar brenda programimit të jetës së përditshme aktive, pasi që horizontet e gjera të diturisë nuk i shpalosen përnjëherë personit që është në kërkim të botës së pafund të urtësive. Libri, i cili deri më sot i është paraqitur njeriut si një mjet argëtimi apo plotësimi së kohës së

lirë, nuk ka arritur ta rrokë efektivitetin e tij në jetën shoqërore, sepse është shkëputur nga thelbi dhe funksioni i tij i vërtetë.

Koordinimi i domosdoshëm në mes kohës dhe librit mund të arrihet vetëm kur individ i ta programojë kohën e tij private dhe duhet organizuar sipas grupmoshave nën dritën e të vërtetave të jetës biologjike që ne e jetojmë si ditë, javë dhe muaj, sepse përvoja e çdo grupmose është e ndryshme nga ajo e grupmoshave të tjera. Libri duhet vendosur në qendër të jetës humane në mënyrë që begatia e stinëve që ikin ta lehtësojnë jetën.

Në jetën tonë në vend të diturisë së ftohtë duhet të zërë vend vlera e librit dhe leximi i tij i rregullt. Ajo që presin njerëzit që nuk ndalin një çast të mendojnë mbi ekzistencën e tyre dhe që nuk i ndërrojnë vlerat njerëzore me vlerat humane nuk kanë shumë çfarë të presin nga librat.

Ndalesë mes dy viteve për llogaritjen e vetes

Po e përfundojmë një vit dhe po presim vitin tjetër. Andaj, ç'duhet të bëjmë për këtë rast? Jemi të obliguar si individë, grupe dhe shoqëri të qëndrojmë qëndrim meditimi dhe përsiatjeje, të marrim mësim, të këshillohemi nga ditët e kaluara, nga muajt dhe vitet e shkuara.

Çdo njëri prej nesh në fillim të vitit duhet të ndalet e të e llogarit veten e tij, për një vit të tërin të kaluar.

Myslimani vazhdimisht duhet të e llogaritë vetveten, llogaritja e vetes është një pjesë e jetës së myslimanit, vetja e tij është qortuese, e qorton vetveten kur tepron në urdhrat e Allahut, apo kur ta bën ndonjë të ndaluar të Allahut. Ai është i ndjeshëm, posedon ndërgjegje të gjallë kur ta bën ndonjë mëkat, apo nëse e humbë ndonjë adhurim, e nuk e mirëpret atë me një zemër të

vdekur, por e pret me një ndërgjegje të gjallë, me një ndjenjë të matur, i thotë vetvetes: Pse e bëra? Pse e lashë? Pse nuk e bëra? Pse nuk e lashë?

Kështu është myslimani, llogaritës i vetvetes me një llogaritje serioze. Myslimani ia ashpërsos llogaritjen vetes, ndërsa të tjerëve ua falë, të tjerët i toleron, sa që disa prej të parëve patën thënë: "Do e falsha vëllain tim deri në shtatëdhjetë arsye, pastaj do të them: Ndoshta ka arsye të tjera të cilat ende nuk i di".

Ky është qëndrimi i tij me vëllëzërit e tij mysliman, edhe nëse gabojnë kundrejt tij, edhe nëse i bëjnë padrejtësi atij, i shfajëson ata, mirëpo ai nuk gjen asnjë arsye me vetveten, e llogarit vetveten me precizitet dhe me seriozitet, siç kishte thënë Mejmun ibën Mehrani, njëri nga tabiinët: "Myslimani është më llogaritës për vetveten sesa një udhëheqës

tiranë, dhe sesa një bashkëpunëtorë koprrac", i trajton gjërat në imtësi e nuk le të madhe e as të vogël pa pyetur për të.

Umer ibn Hattabi r.a. ka thënë: "Kërkojini llogari vetes përpara se të merreni në llogari; peshojini punët tuaja para se t'jua peshojnë; dhe pyetini veten para se të kalojë pyetja te tjetërkush!", sepse në Ditën e Gjykimit do të pyetesh se çfarë ke bërë, veçanërisht për katër çështje: Do të pyetesh për jetën tënde si e ke harxhuar? Për rininë tënde si e ke kaluar? Për diturinë tënde se çka ke bërë me të? Dhe për pasurinë tënde prej nga e ke fituar dhe në se e ke shpenzuar?

Ndalesa llogaritëse përfundimtare për vitin

Myslimani e llogarit vetveten, duhet të e llogarisë çdo natë para se të flejë: Çka kam bërë sot? Çka kam lënë? Nëse nuk



i mundësohet një gjë e tillë për çdo natë, atëherë le të jetë një herë në javë: në mbrëmjen e së hënës, të enjtes apo të premtes, ndalet dhe thotë: Çka kam bërë gjatë shtatë ditëve të kaluara? Çka kam bërë nga të lejuarat dhe të ndaluarat?

Nëse nuk i mundësohet llogaritja e vetes gjatë ditës apo javës, atëherë le të jetë për çdo muaj, sa herë që të fillojë muaji i ri të e llogarisë veten për muajin e kaluar.

Nëse nuk e bënë edhe këtë, atëherë së paku duhet të ndalet në fillim të vitit të ri një qëndrim të gjatë me veten e tij, i rishikon llogaritë e tij, i hap regjistrat e tij me sinjeritet ndërmjet tij dhe vetes së tij, pasi që s'mund t'i dijë ato askush përveç Allahut i Cili e di të fshehtë e asaj që ai ka bërë para njerëzve apo hap-tazi, Allahu i Lartësuar i regjistron ato kundër tij: "A mendojnë se Ne nuk dëgjojmë ndjenjën e fshehtë të tyre dhe bisedën mes tyre? Po, e dëgjojmë dhe të dërguarit tonë (engjëjt përcjellës) që janë pranë tyre, shkruajnë"¹.

Në fillim të vitit duhet të ndalet me një ndalesë të vendosur, gjithëpërfshirëse e të gjatë, ngjashëm siç e quajnë në ekonomi: llogari përfundimtare. Është llogaria përfundimtare e punës një vjeçare, të gjitha do të llogariten: vitet, muajt, javët, ditët, orët, minutat, sekondat, për çdo frymëmarrje nga frymëmarrjet e tua do të pyetesh për të para Allahut në Ditën e Gjykimit, andaj patjetër duhet të llogaritet vetja.

Vlefa e kohës në jetën tonë

Ne teprojmë në kapitalin tonë, e kapitali ynë është jeta, jeta është këto ditë të cilat kalojnë e gati

as që nuk i ndjejmë ato, e as që nuk interesohemi për to. Ti po e humbë jetën tënde vit pas viti, muaj pas muaji, javë pas javë dhe ditë pas dite.

Shumë njerëz thonë: Ejani ta vrasim kohën! E vrasin kohën në dëfrime, në lojëra, në ato që lejohen e ato që ndalohen, e nuk e dinë ata të shkretë, ata të gjorë të cilët e humbasin kohën kotë, se njeriu kur ta vret kohën e tij, në të vërtetë vret veten!

Vrasësit e kohës janë vrasësit e vetvetëve, ata bëjnë vetë-vrasje, nuk është vetëvrasje me thikë e as me plumb, por vetëvrasje e ngadaltë që nuk shihet, vetëvrasje me humbjen e kohës, humbjen e kapitalit, ashtu siç ka thënë Hasen Benna: "Koha është jeta".

Nuk është e vërtetë ajo që thonë perëndimorët se koha është prej ari, ari mund të kompensohet, mund të mos kesh nevojë për arin, mund të jetosh pa arin. Koha është jeta, është më e shtrenjtë se ari, më e shtrenjtë se diamanti, dhe më e shtrenjtë se çdo xhevahir i çmuar.

Koha jote është jeta jote, dhe jeta jote është koha jote, siç kishite thënë Hasen Basriu: "O i biri i Ademit, me të vërtetë që ti nuk je tjetër veç se një grumbull ditësh, sa herë që shkon një ditë, ikën dhe një pjesë e jotja", ti je një grumbull ditësh, çdo ditë që shkon, shkon dhe një pjesë e jotja.

O njeri, jeta jote është koha që shpenzon prej djepit e gjer në varr, që nga lindja e deri në çastin e vdekjes. Nëse e humb apo e vret kohën tënde, e ke humbur jetën tënde, e ke vrrarë vetën tënde.

Është çudi se si ata të cilët e vrasin vetveten (vrasin kohën)



nuk ndëshkohen. Ai që e shpenzon kotë pasurinë ndëshkohet, konsiderohet i pafytyrë dhe i konfiskohet pasuria, ndërsa koha është më e shtrenjtë se pasuria, por ai që e shpenzon kohën kot nuk konfiskohet, ai që e vret kohën nuk ndëshkohet, sepse për fat të keq nuk e ndien krimin e tij të cilin e kryen kundër vetvetes.

Sa kemi nevojë që të ndalemi në fillim të vitit një qëndrim të gjatë, gjatë atyre momenteve çdo njeri të e llogarit vetveten: Ç'ke bërë në të kaluarën? Ç'ke si synim të bësh në të ardhmen? Ashtu siç e trajtojmë në imtësi buxhetin e kaluar dhe e planifikojmë buxhetin e ri. Ç'kam për qëllim të bëjë gjatë këtij viti prej punëve të mëdha: Të jetë Allahu i kënaqur, t'i realizoj synimet dhe gjatë tij të punoj për Ahiretin (botën tjetër)?

Kjo është ndalesa e parë që duhet të ndalet çdo besimtarë në fillim të vitit, kur e përfundon vitin e kaluar dhe e pret vitin e ri.

1. Ez-Zuhruf, 80.

Të lexosh do të thotë të kërkosh

Akti i të lexuarit është një udhëtim i gjatë që nis prej djepit për të përfunduar në varr. Leximet që ndërpriten me mbarimin e edukimit shkollor janë lexime të përgjysmuara.

Leximi është si të hapësh gropë me gjilpërë, kërkon vendosmëri dhe durim.

Leximi është një kërkim për të vërtetën, të saktën dhe të hijshmen. Ajo strehon nën vete entuziazmin e zbulimit sa herë që kërkohet të gjejmë diçka të re. Atëherë kur e gjeni atë që kërkoni vendin e së fshehtës së parë ia zë një e fshehtë e dytë, një e tretë e kështu me radhë. Shpresa dhe entuziazmi janë dy cilësitë e pandashme të leximit. Leximi është kushti i humanizmit, ndërsa shpresa dhe entuziazmi janë kushtet e vitalitetit. Ata që mbijetojnë e arrijnë këtë vetëm në sajë të shpresës dhe përpjekjes. Po që se dëshironi të mbeteni i gjallë

atëherë mbaje gjallë dëshirën dhe kërkesën që pulson në zemrën dhe shpirtin tënd. Të dish dhe të njohësh është e rëndësishme, por më e rëndësishme se kjo është të dëshirosh dhe të kërkosh.

Kërkimi i vërtetë është ai që bëhet në emër të Zotit. Allahu i ka mbushur librin e Tij, tokën dhe qiejt, mikro dhe makrokozmosin me ajetet, shenjat dhe argumentet e Tij. Të gjitha ato të ftojnë drejt Tij dhe të çojnë drejt Atij. Edhe qiejt, edhe toka janë një ftesë për ty.

Qëllimi i leximit është Allahu, fitimi i kënaqësisë së Tij nëpërmjet thirrjeve që shtrihet pas në pafundësi. Ata që këmbëngulin me vizionin e ngushtë dhe vetëm dinë të thonë "lexo, mëso që të gjesh një punë të mirë" me dashje apo pa dashjen e tyre bëhen ata persona që në të vërtetë e ngushtojnë horizontin tonë. Ata kërkohet që në vend të Allahut të vendosin nevojën e kafshatës së

bukës, në vend të zemrës midenë, në vend të mendimit sublim entuziazmin më të vrullshëm dhe në vend të aksionit rehatinë dhe pushimin. Ata mbase nuk e kuptojnë se jetojnë dhe gjallojnë për hatër të Arshit të Lartë të Zotit. Njeriu duhet t'ia ngjis sytë horizonteve që shtrihen tutje, madje edhe përtej tyre tutje tëhu. Ai që arrin të shohë kaq larg arrin të sillet përreth aksit të Allahut, ndërsa ata që e largojnë shikimin e tyre prej këtyre horizonteve fillojnë të rrotullohen vetëm përreth aksit të tyre vetjak.

Të bësh ç'të duash por ky qark ka një përlogaritje të vogël. Njeriu i sotëm e drejton shikimin e tij drejt gjërave të thjeshta duke mos parë çështjet bazë që i nevojiten si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër. Po që se qëllimi i parë dhe i fundit është vetëm të fitohen para dhe në sajë të tyre të sigurohet një jetë e qetë, atëherë nuk kanë ndonjë kuptim as lodhja dërrmuese që duhet bërë



nëpër këtë udhë të gjatë dhe të lodhshme, as psherëtimja e mos-suksesit dhe as shpenzimi i forcës mentale dhe energjisë nervore. Po qe se njerëzimi ekziston dhe zhvillohet në sajë të njerëzve që e mbajnë përherë para sysh nevojën e altruizmit dhe sakrificimit, atëherë ekzistenca jonë në mënyrë të pashmangshme duhet të ketë edhe një dimension metafizik.

Udhëtarët që janë nisur udhës që të çon tek Allahu duhet ta kenë parasysh që ta përdorin sa më mirë kohën që kanë në dispozicion në këtë botë. Jeta e njeriut është aq e shkurtër sa është edhe harku i tendosur mes dy pafundësive. Lumturia e njeriut në këtë botë dhe në botën tjetër është e lidhur me faktin se sa mirë dimë ta përdorim kohën që kemi në dispozicionin tonë. Shpërdorimi është i keq në çdo situatë dhe në çdo rast, por shpërdorimi i jetës është e keqja më e madhe që mund ti bëj njeriu vetvetes. Të gjithë llojet e produktivitetit janë të lidhura me përdorimin në mënyrë të duhur të shëndetit dhe të kohës së lirë. Po qe se e bëjmë rrush e kumbulla kapitalin tonë që na është dhuruar në këtë jetë mjerë për jetën tonë në këtë botë dhe në botën tjetër. Myslimani si besimtar i një feje e cila në tekstet e saj të shenjtja ka regjistruar

betimin hyjnor mbi rëndësinë e kohës dhe të jetës së njeriut, nuk duhet ta shpenzojë më kot qoftë edhe një minutë të jetës së tij.

Ata që e vlerësojnë dhe e pranojnë leximin dhe të shkruarit në veprimtari bazë të jetës së përditshme duhet ta shpenzojnë çdo situatë dhe kohë të përshtatshme për të lexuar dhe për të shkruar, por pa e lënë pas dore edhe faktin se lodhja ka nevojë për relaks dhe pushim në mënyrë që të jemi sa më produktiv. Ashtu sikurse duhet të vazhdojmë të punojmë në kohë të përshtatshme, të qetë dhe me kohë të gjatë, ashtu edhe duhet të vlerësojmë edhe çastet që krijohen gjatë pushimit të aktiviteteve të ndryshme të jetës në mënyrë që ti plotësojmë këto çaste me lexime informative. Nuk është e pakët as mundësia që të arrijmë të jemi frytdhënës edhe duke vlerësuar ato momente të shkurtra që krijohen për të lexuar.

Librat që duhet të lexojmë duhet të jenë më të vyerit dhe me përmbajtje më të pasur. Pas Kuranit dhe librave të hadithit vjen çdo libër me vlerë për tu lexuar. Këtu nuk e ndjej të nevojshme që të zgjatem shumë mbi kushtin që libri që lexojmë të jetë i mbështetur mbi bazat e pedagogjisë.

Librat që mund të lexohen janë

të shumtë, ndërsa jeta është e shkurtër dhe kapacitetet njerëzore janë të kufizuara. Prandaj është më se e rëndësishme që të lexojmë duke përzgjedhur.

Sa do të dëshironim që orët e mësimi të mos ktheheshin në çaste të mërzitshme, që mësuesit të ishin që të gjithë njerëz idealist të edukuar sa më mirë që të jetë e mundur, që temat mësimore të na shpinin në botët ngjyranjyra, të mos kuptojmë sesi kalon ora e mësimi, ta prisnim pa durim orën tjetër të mësimi. Vallë vdiqën pasardhësit e profetëve, heronjtë e panjohur të profesionit që përhap mësimin mbi Zotin në këtë botë të thellë dhe të llojlojshme. Le të jenë ata edhe dy-tre yje që shkëlqejnë në horizontin e largët. Le të besojmë se edhe në këto kohë moderne do të vijnë besimtarët me mendjen e stërvitur, me zemrën e mbushur plot besim, me shpirtin që dashuron dhe të guximshëm për tu njohur me enigmën e madhe të gjithësisë.

Le ta zëmë se kushtet në të cilat gjendemi sot nuk janë të përshtatshme për misionin e një besimtari të devotshëm në këtë botë, atëherë ne do të duhet të kërkojmë rrugëzgjdhjet nga do të shkojmë në mënyrë që niveli ynë të rritet. Mbase është e vështirë ta vazhdojmë me dëshirë dhe

kënaqësi udhëtimin e diturisë, por kaderi ynë është që të mund të arrijmë ta bëjmë këtë gjë brenda vështirësive duke shpenzuar të gjithë përpjekjet tona në mënyrë që të gëzojmë lumturinë e madhe në fund të kësaj jete.

Njeriu lexon, kërkon dhe gjen. Atë që e gjen pas leximit duhet ta shënojë se s'bën diku. Nëse nuk e bën këtë atëherë ai do të harrojë sa e sa njohuri të vlefshme si pasojë e kalimit të kohës. Kam dëgjuar të thuhet se në moshën dyzet e pesë vjeçare njeriu fillon të përfitojë nga njohuritë që ka marrë kur ka qenë në moshën pesëmbëdhjetë vjeçare. Mos të harrojmë se edhe Allahu ia mësoi njeriut diturinë duke i falur aftësinë e të shkruarit.

Njeriu hedh në letër dhe i shkruan edhe ndjenjat dhe mendimet e tija. Ai shkruan në atë gjini në të cilën ndjehet mirë dhe për të cilën ushqen interes. Të gjitha këto bëjnë që truri ynë edhe të stërvitet, edhe të jetë prodhimtar.

Të shkruash do të thotë përpjekje për të shpëtuar ndonjë gjë nga dora e kohës që fshin dhe mbulon me pluhurin e harresës çdo gjë që i del përpara dhe realizim relativ i prirjes sonë për tu mos harruar. Të shkruash do të thotë të bashkëbisedosh me

brezat, ti kumtosh të ardhmeve të largëta dhe të përjetosh lumturinë që të fal prodhimtaria në një fushë të jetës. Ata që nuk i kushtojnë rëndësi shkrimit janë ata që nuk i japin rëndësi faktit nëse truri dhe mendja e tyre mbeten apo jo të pafrytshme dhe të dobëta apo nëse u shkon dëm apo jo përvojat jetësore që kanë mbledhur në vite.

Natyra është miku më i mirë për njerëzit që e kanë me pasion leximin. Ajo është miku i tyre edhe se u mundëson vazhdimësinë e procesit së të lexuarit, edhe se u fal një mjedis relaksues. Një lexim i jetës që fillon dhe mbaron vetëm me fletët e librave të shpie në depresion dhe në mërzë shpirtërore. Akti i të lexuarit duhet të fillojë me librin, por duhet të vazhdojë në jetë dhe në natyrën që na rrethon. Njeriu duhet të rrijë dhe ti mendojë gjerë e gjatë lidhjen e ndërsjellë mes shkakut dhe pasojës. Ai nuk duhet të mbetet vonë që të kalojë nga librat drejt e në jetë dhe në gjirin e natyrës që e rrethon. Ai nuk duhet ta humbasë entuziazmin dhe gjallërinë që ka. Çdo vështrim i lëshuar me koshiencë është një e lexuar më vete e natyrës. Njeriu duhet të lexojë edhe librat, por edhe jetën dhe natyrën. Toka dhe qiejt janë një libër, një thirrje, një kumt.

Ngaqë nuk është asnjëherë e ditur se kur dhe çfarë i sjell truri ndër mend njeriut gjatë jetës dhe se çfarë do të dëgjoj dhe ku do ta dëgjoj atë, atij nuk duhet ti mungojë në xhep asnjëherë letra dhe lapsi. Ai duhet ti hedhë menjëherë në letër ndjenjat dhe mendimet që ndjen apo gjërat e bukura që i shohin sytë, në mënyrë që më pas ti transmetojë ato në një vend më të përshtatshme. Këtë mund ta quajmë edhe një lloj gjuetie të diturisë dhe të përsiatjes.

T'ua bëjmë të njohura ndjenjat, mendimet dhe konstatimet e bukura që gjetëm edhe vëllezërve tanë në besim nga një anë është shkak që të meritojmë kënaqësinë e Allahut, nga ana tjetër na mundëson të provojmë ëmbëlsinë që të fal posedimi i "një dore, një truri apo një shpirti që dhuron". Sa e bukur është që edhe ne ashtu siç bënë profetët t'ua dhurojmë robërve dhe shpirtirave ndjesinë apo përsiatjen që na mundësoi të përjetonim Allahu, Zoti ynë.

Ata që nuk dinë të marrin edhe nuk dinë të japin, sepse vetëm Allahu është ai që dhuron pa marrë gjë prej atyre që u jep, ndërsa njerëzit jemi në pozitë e krijesave që japim duke marrë. Kjo nga një anë do të thotë të lexojmë vazhdimisht dhe të rritemi në informacion mendor

dhe shpirtëror, nga ana tjetër do të thotë ti rrisim edhe të drejtët në këtë drejtim. Nuk kanë thënë më kot se njerëzit mësojnë duke u mësuar të tjerëve.

Në këtë pikë do të dëshiroja të flisnim edhe për dëshirën e të lexuarit. Njerëzit që nuk e kanë dëshirën e të lexuarit do të thotë se janë gjysmë të arsimuar dhe gjysmë të edukuar. Meqenëse Allahu i cili krijoi natyrën njerëzore na urdhëron që të lexojmë kjo do të thotë se në natyrën njerëzore ekziston prirja për të lexuar. Prandaj të vjen për të ardhur keq që një arsimim apo edukim shkollor i mbështetur mbi një plan-program lëndësh i pambështetur në bazat e mësimdhënies ta shkatërrojë këtë prirje humane në vend që ta zhvillojë atë duke zgjuar një lloj acarimi kundër të lexuarit.

Jo çdo libër mund të lexohet në çdo kohë. Libri që duhet të lexoni kur jeni i lodhur është tjetër, libri që lexoni kur jeni relaksuar dhe mendje të qetë është tjetër. Libri që lexohet në periudha kohore të shkurtra duhet të jetë i ndryshëm nga ai që lexohet në periudha kohore të gjata. Kur jemi të lodhur ne duhet të lexojmë poezi, fjalë të urta, sentenca etj si këto, por jo libra të mendimit. Një roman nuk duhet të filloni ta lexoni kur nuk keni kohë të gjatë në dispo-

zicion.

Një princip që duhet ta kemi parasysh është edhe të përsërisim shënimet që mbajmë. E zëmë se keni mbajtur shënime nga qindra libra. Këto shënime ju mund ti përsërisni kur shtriheni për të fjetur, kur jeni duke pritur autobusin apo kur jeni në udhëtim. Ky është një reokupacion shumë i lezetshëm dhe shumë produktiv. Në mënyrë të veçantë informacioni i mbledhur nëpër fishe përsëritet më me dëshirë.

Njeriu në këtë botë nuk mund të gjejë çdo gjë që e kërkon, prandaj nuk duhet të zhgënjehemi në qoftë se nuk e gjejmë atë që kërkojmë. Ne duhet të kërkojmë rrugët që na bëjnë të lumtur me ato që kemi gjetur. Jemi dëshmitar se shpeshherë privimet e çojnë njeriun drejt dhimbjes.

A ndiheni se janë duke jua hedhur të tjerët? Atëherë bëhuni më shumë punëtor, që të përjetoni entuziazmin që të dhuron fakti kur fitoni terren të madh në një kohë të shkurtër.

A keni parë se disa kokrra kafeje janë prishur? Nga kjo nxirni mësimin se kohën dhe energjitë tona nuk duhet ti shpenzojmë më kot asnjëherë të vetme. Prandaj në vend të pushimit duke u shtrirë sa gjerë e gjatë preferoni

të pushoni duke ndërruar punën me të cilën jeni duke u marrë. Hiqeni lodhjen e trurit duke vënë në punë trupin dhe gjymtyrët tuaj. A keni parë njerëz që flasin në ajër? Mendoni se si mund të flisni përherë gjëra me vlerë. Mos e hiqni nga mendja se edhe në vendbanimin ideal në shtëpinë e paqes në xhenet nuk ka për tu dëgjuar fjalë të kota.

Dijeni se pa dyshim ekzistojnë armiqtë që mbështeten dhe drejtohen nga një kuadër i përgatitur intelektual. Ata janë të vendosur që myslimanëve tu japin fund në sajë të kurthit të epsheve dhe të famës. Lojën e vërtetë ata e luajnë me të rinjtë myslimanë. Po qe se shejtani dhe përkrahësit e tij janë tinëzar dhe hileqarë, myslimani i devotshëm dhe i përkushtuar duhet të jetë mendjehollë dhe largpamës në mënyrë që të mos bjerë në kurthin e epshit dhe të famës. Mos i jep vlerë asnjë gjykimi vlerësues që nuk e pranon metafizikën. Ekzistojnë horizontet e largëta dhe ka edhe përtej tyre.

Nga djepi i shtëpisë shkojmë drejt djepit të tokës duke lexuar. Nganjëherë lexojmë mes radhësh, herë të tjera mes kujtimesh. Nga njëherë lexojmë sytë, ndërsa herë të tjera lexojmë zemrat. Ndonjëherë lexojmë nga libri, herë të tjerë nga thirrja që na bëhet...



Mbi leximin

Çdokush që pretendon se është i ndjeshëm ndaj qëllimit të ekzistencës në planin individual dhe atë social, dhe që është i interesuar rreth gjeografisë në të cilën realizohet ky qëllim të paktën aq sa është i interesuar edhe për ato që ngjajnë në zonën ku jeton ai, para së gjithash duhet ta konsiderojë vetveten përgjegjës për zhvillimet negative që i vë përpara koha e cila kalon, dhe duhet ta mendojë mirë se cila është pjesa e tij në këto lajthitje dhe përgjegjësi kolektive.

Nga aspekti kombëtar, myslimanët e shumë shteteve myslimane, duke filluar nga bujku në fshat dhe duke përfunduar deri tek njerëzit e kënduar në qytet, që të gjithë merren më shumë se gjithçka me “thashethemet e të tjerëve”. Unë mendoj se në ditët e sotme kur është bërë e modës “të nxirret mësim nga situata”, do të ishte e vlefshme të bënim një shëtitje të shkurtër drejt fushave të “përgjegjesisë personale” duke pasur parasysh përherë “panoramën e përgjithshme”.

Vallë përse kemi ardhur në këtë gjendje? Sipas meje, më e rëndësishmja nga mesi i përgjigjeve që mund t’i jepet kësaj pyetjeje është se ndoshta ne i kemi harruar pa i marrë aty ku i kemi lënë, mbase me mendimin se do të shkojmë ti marrim atëherë kur të na nevojiten, sitën e zemrave që do të na duhej ta mbanim vazhdimisht pranë vetes në mënyrë që të shkoqim

dhe përzgjedhim fundërrinat e atyre që ngjanë. Ata që shqetësohen dhe marrin mundin që të shkojnë dhe ta marrin atë sitë e dinë shumë mirë se fijet e saj ka kohë që janë kalbur. Besoj dhe jam i sigurt se ajo për të cilën kemi aq shumë nevojë para së gjithash dhe mbi gjithçka është sita e zemrave që do të na vrente për shumë gjëra.

Po qe se do të flisja në emrin tim do të thoja se konstatimi që më ka ndihmuar më shumë se çdo konstatim tjetër gjatë analizës që i kam bërë atyre që ngjajnë përreth nesh brenda kësaj periudhe kohore që jetojmë me fjalë të tjera analizë e çdo ndodhie apo shfaqjeje që do të mund të hynte në klasën e “tjetrit” është se:

Shpirtrat e njerëzve janë shtyrë tutje tëhu ku as ato vetë nuk e dinë se ku janë. Dhe kjo është bërë në një mënyrë të habitshme. Nuk më vjen aspak ta besoj se mund të jetë e mundur që shpirti i llojit njerëzor të jetë shtypur dhe të jetë munduar më shumë se sa ditët e sotme. Mbase dikush mund të mendoj edhe se e kam gabim.

Fjala vjen, si dhe ku e lexojmë një revistë, një gazetë apo një libër që marrim ta lexojmë? A na ka shkuar ndonjëherë ndërmend se etapat që kalojnë ato derisa të botohen apo se udha që ndjekin ato deri sa të shohin dritën e shtypit dhe botimit janë rezultat i një pune të jashtëza-

konshme, i një sforcimi të madh të dritës së syve dhe e një përpjekjeje titanike? Nganjëherë më duket se ato që i lexojmë, edhe në mos nga niveli mendor dhe perceptues por nga niveli shpirtëror, ne nuk i marrim seriozisht sa duhet që ti marrim. Aq më shumë që dimensionin shpirtëror i të shkruarit dhe i të lexuarit si shkak i ekzistencës së të parës ashtu sikur se ngjan në shumë çështje të tjera është shumë i rëndësishëm.

Vallë a arrijmë ti hapim perdet e shpirtit gjatë aktit serioz të leximit që përmban në vetvete edhe rëndësinë e urdhrit të parë hyjnor që iu shpall profetit Muhamed, kjo si shtesë e syçiltërsisë mendore që të kushtëzon leximi? Ka shumë dallim ndërmjet depozitimit të fjalëve, fjalive dhe paragrafëve në depot e pasme të inteligjencës sonë me mendimin që mbase një ditë do të na duhet të përdorim ndonjë fjalë, të transmetojmë një paragraf apo të lëmë një shënim dhe përhapjes së atyre që lexojmë nëpër fushat e shpirtave dhe të lehes së serave të zemrave.

Të vënë palë të fjalëve në tru sjell me vete edhe mundësinë e kalbjes së tyre aty. Për këtë arsye janë të shumtë “lexuesit” që përhapin një frymë të mbrapshtë edhe se ajo që mund të prodhohet me mendjet e tyre njerëzit e pashkolluar dhe që nuk kanë ditur të gjejnë kohën për të lexuar si të parët. Ata që ua shërbejnë konservat e fjalëve në banakun

Zëri i shpresës

e zemrës dhe të shpirtit janë ata që kanë ditur ta kuptojnë me të vërtetë “urdhri lexo”. Këta persona kanë kuptuar se ashtu sikur se çdo çështje tjetër edhe “urdhri për të lexuar” është një begati “e favorshme për tu konsumuar sa më parë”.

Teksa shfletojmë fletët e një organi botimi që na e ka këshilluar ta lexojmë ndonjë person fjalë e të cilit ka vlerë për ne apo kur tregojmë drejtësinë që të preferojmë vetë ne mes këtyre organeve ne duhet të jemi të ndërgjegjësuar dhe të përjetojmë entuziazmin e kryerjes dhe përmbushjes së urdhrit “për të lexuar”. Duhet të tregojmë kujdes që të mos kalojmë nga një faqe në faqen tjetër të shkrimit që lexojmë pa e përkëdhelur mirë fjalët dhe fjalitë që mbushin ato faqe, të cilat herë na buzëqeshin, herë ngrënë vetullat përpara nesh, herë rrjedhin si një përrua i qetë mes lëndinave të shpirtit tonë ose derdhen në to si currilat e një ujëvare. Nga ana tjetër, duhet të mendojmë se akti i të lexuarit meriton një interesim më të veçantë pasi që është edhe urdhri i parë të cilin na e ka drejtuar neve Zoti ynë.

Të lexosh është një akt po aq i përshpirtshëm sa është edhe të shkruarit.

Pyetja se “Si duhet lexuar” përkrah pyetjes se “Çfarë duhet lexuar?” nuk duhet të qëndrojë e varur nën hijen e pretendimeve bombastike që zënë gjysmën e pllakave të shpalljes dhe të kumtimit fetar duke bërë kështu që të mos kapim kuptimin e mirëfilltë të ajeteve dhe haditheve. Për mendimin tim gjëja më e saktë do të ishte që çdo herë ti vendosim këto pyetje pranë njëra-tjetrës.

Kthimin nga puna për në shtëpi më është bërë zakon ta bëj gjithnjë në këmbë. Ecjen time e kam disi të shpejtë, por sot s’di se pse eci me ngadalë. Një ngrohtësi pranverore filladiste trupin tim. “Ç’gënjeshtare që qenka kjo erë. Pranvera është akoma larg. Ajo vjen vetëm në kohën e saj”

- Po mendoja... Por ngrohtësia e mjedisit po më ngacmonte shumë ndërsa po ecja në rrugën që i njihja çdo gurë që nga fëmijëria. Ishte koha apo ndizesh trupi im? Për çudi ndonëse eci në “rrugën time” shoh parasysh gjëra krejt të tjera. Vazhdoj të eci por...kam humbur drejtimin. Një ankth që më ka zënë po më kalon në shqetësim. Pse? Njerëzit që kalojnë pranë meje më duken tërë ankth. Nxitojnë. Seç pëshpëritin me njëri-tjetrin. Në një stacion autobuzi 7-8 vetë më duken si një ansambël skulpturor. Mes tyre heshtje. Unë mendoj se ç’do bëjnë këta nëse nuk vjen autobuzi i fundit. Po ata ç’mendojnë? Vras mendjen. “Çfarë u mungon këtyre njerëzve që sillen kështu me veten, me mua, me gjithë botën?!” Mendoj...


...Sapo kisha hedhur tre hapa dëgjoj brenda vetes time sikur dikush më dha një përgjigje me zë të forte. “Shpresa!”. Papritur pyes me zë të lartë “Kush?!”. Përsëri ai zë mu përgjigj. “Shpresa tek Zoti, shpresa tek lumturia?”. Kush je ti? – pyes përsëri unë. Por asnjë përgjigje, shikoj rreth e rrotull dhe vë re se jam vetëm. Po me kë folë unë atëherë?! O Zot, ç’është sot kështu me mua...? Mendoj...

...Po, po! Ai zë ishte “zëri i Shpresës”. Zoti atë e ka futur brenda nesh, por ne shpesh e mbysim simfoninë e tij me notat pa kuptim të jetës tonë. Ç’muzikë të keqe që luajmë ne njerëzit e kësaj bote. Të gjithë muzikantë, të gjithë dirigjentë të vetvetes. Njerëz që s’dinë të ngrënë orkestër. Sa keq! Ndodh, kështu sepse nuk kemi gjetur dot akoma dirigjentin e jetëve tona të përbashkëta. Në këto mendime që kishin jo pak mllef, ai zëri i brendshëm fillojë të më flasë përsëri: Eh, moj Elona! Nëse njerëzit do të udhëhiqeshin nga e mira, do të besonin me plot shpresë tek lumturia, do të zbatonin mësimet e të madhit Zot çdo gjë do të ishte ndryshe. Udhëhiquni nga Zoti dhe jeta juaj do të ndryshojë.

Dashuria e tij për njeriun është e pakufishme. Ai dhe vetëm ai lehtëson dhimbjen, të jep dashurinë dhe mirësinë. Thërriteni Atin tuaj të përbotshëm dhe Ai do të vijë e të ulët lehtë – lehtë në zemrat tuaja, duke ju dhënë atë që s’do t’iu humbasë, gëzimin, shpresën e mirëkuptimin. Tani...

Ouuu – dëgjoj një zë dhe përmendem. Njëra nga plakat e shkallës time (s’ia kujtoj emrin) ishte rrëzuar në shkallë. Vrapova dhe e ngrita. “Të bekoftë Zoti moj Elona” – më tha dhe vazhdoj të ngjitet shkallët. Unë s’po mblidhja veten. Ç’u bë zëri që më foli pak më parë? Ç’ishin gjithë ato fjalë hyjnore?!

Dikush më kishte thënë se Zoti komunikon me njerëzit në forma nga më të ndryshme dhe me anë të engjëjve. Padyshim me mua kishte folur “Engjëlli i Shpresës”, zëri i tij po ndryshon jetën time. Për këtë fat i falem çdo ditë Zotit të vërtetë. Unë jam e tija. Tek unë “Zëri i Shpresës” erdhi kështu siç ju tregova. Provojeni ta kërkonin engjëllin e saj dhe ai do të jetë me ju.



Pse Haxhi?!

Rrugëtimin do e fillojmë këtu, në gërmadhat e mendjes dhe zemrës të lidhur pas horizontit blu! Ndoshta pamja do të na qëndisë brengat një ndër një sikur të ishin pjesë e një rrëfimi pafund. Sikur vezullimi të fishkëllente nga era e rëndë në shkretëtirë. Dikur jeta dukej e rënduar, e largët, e struktur në mendësinë arkaike. Tashmë ka një arsye të secilës pyetje të dalë në skenën e ndjenjave. Ndoshta vargu i tyre do të ishte i gjatë deri në kozmos, ndoshta bishtërimi i tyre do të rikthente fuqinë e dogmës, por në esencë, fillimi është mu aty!

Ibrahimi a.s. sipas rrëfimeve kur anore ishte babai i të gjithë Pejgamberëve të Allahut. Zaten ai thirrej edhe si "Halilullah" – "Mik i Allahut". U kthyem te Ibrahimi a.s. për të kuptuar e mësuar rëndësinë e të qenurit rob i Allahut, i nënshtruar ndaj Allahut, thirrës, i sprovuar e pelegrinë. Zaten jeta jonë në këtë botë është një pelegrinazh që fillon me ardhjen tonë në këtë botë, e mbaron në momentin e futjes në tokë. Në botën e mëpastajme kemi korrijen e të mbjellave nga ky pelegrinazh jete. Ndoshta për dikë do jenë shekuj thatësie, por për disa të tjerë do ketë fryte të

llojllojshme të cilat janë të përshkruara në gjuhën e pastër të Kur'anit. Bota njihet shtëpinë e shenjtë, Qabenë! Por, ndryshkja e zemrave nga injoranca, mosbesimi dhe veset e këqija e sjelli njerëzimin në atë nivel që të bëjë tavaf rreth Qabesë edhe lakuriq. Çmenduria e njerëzve arriti deri në këtë shkallë! Ibrahimi a.s. babai i sakrificave dhe historisë së popujve në rruzullin tokësor, është rrëfimi i një tregimi të boshatisur. Ai, së bashku me djalin e tij Ismailin a.s., u kujdesën që të ndërtojnë shtëpinë e shenjtë Qabenë! Zaten kur ne kryejmë pelegrinazhin në Haxh, kujtojmë gati çdo detaj të jetës së

Ibrahimit a.s.

Në këtë mënyrë mësojmë komunikimin e një babai me fëmijën e tij, mësojmë sakrificën e tij në rrugën e Zotit, mësojmë durimin e gruas së tij Haxheres, mësojmë vendosmërinë e djaloshtit të tij Ismailit a.s. Jeta e Ibrahimit a.s. është mësim dhe shembull për popuj të tërë se si të jetojnë në paqe me Allahun dhe në dashuri e harmoni me të gjithë njerëzit tjerë. Ai për asnjë moment të jetës së tij nuk u largua nga rruga islame edhe pse djalli u mundua që ta bind ta kthej veten prej vendosmërisë dhe bindjes në rrugën e Zotit. Djali i Ibrahimit a.s., gruaja e tij dhe vet ai e gjuanin djallin me gurë, duke e larguar prej veprimtarisë së tij në thyerjen e urdhrave të Zotit.

Kur shkojmë dhe kryejmë Haxhi, ne nuk guxojmë që të kuptojmë se po bëjmë vetëm një shëtitje në shtëpinë e shenjtë dhe misioni ynë të përfundoj me kaq. Ne shkojmë atje, për tu vetëdijesuar se në rrugën e Zotit do e flijojmë edhe veten po edhe familjen tonë, dhe do të bëjmë çmos që Allahu të jetë i kënaqur me ne. I japim mesazh djallit të mallkuar se ai nuk guxon për asnjë moment të jetës sonë të na mashtrojë e të na ndërroj mendje rreth realizimit të urdhrave të Zotit me përpikëri.

Mesazhet dhe urtësitë e Haxhit janë të pafundme. Ndoshta vet jeta jonë përfshihet aty! Jo rastësisht Resulullahu s.a.v.s. ka thënë: "Një haxh i pranuar tek Allahu, nuk ka shpërblim tjetër veçse parajsën."

Haxhi është kusht i Islamit, i cili duhet që të realizohet

nga myslimanët një herë në jetë, edhe atë nëse ka mundësi materiale. Me këtë nënkuptojmë se myslimanët e kanë obligim që të bëhen të pasur në këtë botë, përndryshe pa pasuri nuk kryhen as kushtet islame, si është haxhi e zekati, po edhe kushtet tjera islame. Islami e urren që myslimanët të jenë të papunë, parazitë, dhe të mos kërkojnë zgjidhje efektive në këtë botë. Islami është kundër atyre personave të cilët në emër të asketizmit e urrejnë këtë botë dhe nuk punojnë në të, e në këtë mënyrë bëhen barrë e komunitetit mysliman. Nëse Allahu nuk na mundëson që të jetojmë përmes një zanati të mësuar në ndonjë shkollë të mesme ose të lartë, atëherë e kemi për obligim që të mësojmë ndonjë zanaat tjetër, me qëllim që të mos rrimë duarkryq dhe të bëhemi barrë e shoqërisë. Allahu e urren të varfrin mendjemadh, ndërsa Pejgamberi s.a.v.s. në një thënie të tij thekson: "Dora që jep është më e mirë sesa dora që merr." Kur Omeri r.a. gjente disa të rinj të cilët rrinin në xhami tërë ditën dhe ishin të varfër, e nuk dilnin të kërkonin rrizkun e Zotit, ai me shkopin e tij i rrihte me qëllim që ti mësoj të mos bëhen barrë e shoqërisë, por që të kërkojnë furnizimin e Zotit.

Haxhi është vëllazërim, dashuri, mirëkuptim, falje dhe lutje. Sot, janë të njohura të gjitha këto terme në teori, ndërsa në praktik asnjëri prej tyre nuk realizohet. I pamundësohet dikujt që të kërkojë furnizimin e Allahut në këtë botë, ndërsa vëllai i cili ka furnizim me bollëk nuk kujdeset



për të duke u arsyetuar se ai ka punuar për atë bollëk dhe nuk ka nevojë që ta ndaje me vëllaun e tij. Arsyetime të këtij lloji gjejmë shumë në mesin e shoqërisë sonë. Ne ndoshta edhe kryejmë të gjitha ritet e Haxhit, por kemi humbur prej jetesës sonë konceptin e mirësisë, mëshirës, paqes e dashurisë. Bota është futur në zemrat tona dhe i ka egërsuar ato. Të rinjtë sjelljen keq me më të vjetrit, të vjetrit nuk i mësojnë të rinjtë dhe nuk i vlerësojnë kontributet e tyre. Bota është shndërruar në një ferrë të cilin po e përjetojmë me sytë tanë. Po i kthjem sytë kah titulli i këtij shkrimi, dhe të pyesnim veten Pse haxhi?!, me siguri përgjigja e kësaj pyetje do ta merrte një jetë të tërë hululumtim. Prandaj, lusim Zotin që këto shkronja të shkruhen në veprat tona të mira. Kumedit, ndoshta lexuesi do e përjetojë edhe episodin tjetër!

Njeriu i turmës

Në mjaft raste të zhvillimit të spirales historike të shoqërisë njerëzore janë shfaqur “fenomenet shoqërore totale”. Në kuptimin e këtij nocioni natyrisht përfshihet ë gjithë veprimtaria e një grupi shoqëror, të një kombi, apo të disa kombeve. Faktet kanë dëshmuar se në përshkrimin e kësaj spiraleje historike që thamë më sipër janë shënuar si shkaqe shmangie të shoqërisë njerëzore nga e vërteta absolute që është besimi në një Zot (Xh.sh) të vetëm. Pas kësaj shmangie shoqëria njerëzore historikisht është ballafaquar me degradim moral me luftëra në mes kombeve me rënie ekonomike ose me instalim të formës së diktaturës në rrafshin politik etj. Megjithatë ne do të flasim për idetë e

gabuar të cilat janë prodhim i shmangies nga rruga e besimit në një Zot (Xh.sh) të vetëm sikurse thamë më sipër. Po ta vështrosh këtë problem në pikëpamje racionale, duket një problem i cili në esencën e tij nuk e meriton të quhet problem. Por n.q.s këtë e vështrojmë duke u mbështetur në përvojën jetësore pra në mënyrë empirikë. Atëherë kjo çështje në realitetin e sajë ka qenë është dhe do të jetë problem, i njeriut si individ, i shoqërisë si kolektiv i kombit si tërësi, dhe i njerëzimit si gjini njerëzore. Natyrisht kur shmangesh nga Tevhidi i vërtetë, do të thotë të shmangesh nga Zoti (Xh.sh) të shmangesh nga vetvetja dhe në fund të fundit do të thotë të shmangesh nga arsyeja se

përse je krijuar në këtë botë. Atëherë duke lënë pas rrugën e realizimit të identitetit njerëzor. Në mënyrë të domosdoshme do të përqafojmë një rrugë tjetër e cila kjo rrugë nuk realizon identitetin njerëzor por realizon shmangien nga ky identitet. Në mënyrë të koncentruar rrugët e shmangies nga identiteti njerëzor i kemi shënuar në tre pika të cilat janë:

- a) Të kuptuarit e gabuar të origjinës së vetvetes.
- b) Të kuptuarit e gabuar të ekzistencës dhe formimit të botës.
- c) Të kuptuarit e gabuar se përse ekziston në këtë botë.

Pra n.q.s në këto tre pikëpamje i vlerësojmë totalisht më “peshën” reale

të rëndësës së tyre në psikologjinë e njeriut. Atëherë askush nuk mund ti kundërvihet faktit se ato sjellin një deformim shpesh herë dhe fatal në psikologjinë e tij. Dhe ky deformim total i njeriut i cili përfaqon absurdin në vend të së vërtetës Hyjnore përfaqon irrealen në vend të reales përfaqon të përkohshmen në vend të së përrjetshmes, është shprehur deri tani me ngjyrat më të qarta në filozofinë ekzistencialiste të Sartrit ku ai shkruan "Njeriu..në vend që të jetë një shkumë, një mbeturinë, ose një lulëlakër..ai rastësisht është një njëri" (Jean Pol Sartre). Ekzistencializmi është humanizëm fq. 16-17, Phoenix 1997). Ndërsa Joseph. M. Bocheschi shkruan përsëri duke iu referuar Sartrit në librin e tij (Ftesë për të filozofuar fq 69 Prishtina University Press 2000). "Çdo gjë, thotë ai është e papërligjur. Çdo gjë ekziston megjithëse është e panevojshme. Ekzistencën e sendeve për shembull të kësaj rrënje pemë nuk mund ta shpjegosh. Atëherë në biem në përfundimin logjik së çdo qenie, sidomos njeriu është një ekzistencë absurde e pakuptimë". Ne iu referuam Sartrit sepse ai është për fat të keq kulmi i ateizmit botëror. Mendojmë se me këto pak referenca por substanciale që shkëputëm nga filozofia e tij, sadopak në imagjinatën e lexuesit janë formuar megjithëse në mënyrë mjaft të mjegullt konturet e humnerës së tmerrshme të ateizmit. Megjithatë të flasësh për ateizmin dhe labirintet e tij mundësitë tona janë mjaft të varfra. Arsyeja është se ateizmi për-

fshin atë nocion që thamë më sipër dhe që quhet "fenomene shoqërore totale" Prandaj ai ateizëm si fenomen paraqet një pafundësi temash dhe problemesh të cilat manifestohen nga njerëzit nga të gjitha format praktike dhe subjektsh spirtërore. Natyrisht këto forma shfaqen në gjininë njerëzore në momentin kur ai dmth njeriu degradohet gjer në mohimin e ekzistencës së Krijuesit të tij. Por çfarë është njeriu persë ai është një qenie e alternativës. Përse nuk është njeriu një qenie e cila është stabile dhe të respektojë në pikëpamjet e tij Krijuesin. Në lidhje me këtë çfarë thamë më sipër lë të flasim në mënyrë tepër sipërfaqësore për qenien me trup biologjik, por me një shpirt pafundësisht të larmishëm dhe më një botë më një densitet të pafundmë ndjenjash që është njeriu. Në radhë të parë njeriun le ta shohim në vizionin filozofik "Natyra esenciale e njeriut kërkon lidhjen e tij me Zotin (Xh.sh) pafundësinë. Gjendja ekzistenciale e tij është pasojë e tjetërsimit d.m.th shkëputjes së tij nga Zoti (Xh.sh). Prandaj në qoftë se veprimet e një njeriu e largojnë atë më shumë nga Zoti (Xh.sh) tek ai atëherë bashkohen tjetërsimi dhe dëshpërimi. Kjo është arsyeja që nuk vlen ta humbasim veten në një turmë, cilado qoftë natyra e turmës ose kolektivit qoftë e pasur ose e varfër, ose politike në përbërje - në çdo rast thotë Kierkegard, në vetë konceptin e saj turma është e pavërteta, për arsye të faktit që ajo e bën individin plotësisht të papërgjegjshëm dhe pa pendesë ose të paktën do-



bëson ndjenjën e tij të përgjegjësisë duke e reduktuar atë në një grimcë" (Samuel E. Stumph. Filozofia fq 444. Toena). Në mbështetje të kësaj çfarë thotë Kierkegard le të shohim një sentencë homologe nga Erich From në librin e tij "Psikanaliza dhe Feja, bot Plejad 2002 fq 57) "Njeriu për nga origjina e tij është kafshë kopeje. Veprimet e tij janë të përcaktuara nga motive instiktive për ta ndjekur pas udhëheqësin dhe për tu ndodhur në një kontakt të ngushtë me kafshët që e rrethojnë atë(kupto njerëzit). Përderisa jemi të ngjashëm me delet, për ne nuk ka kërcënim më të madh sa ta humbasim këtë kontakt me kopenë dhe të gjendemi në vetmi. Më poshtë autori vazhdon – E mira dhe e keqja e vërteta dhe gënjeshtra, të gjitha këto përcaktohen nga kopeja. Megjithatë në gjithësi nuk jemi vetëm dele. Ne jemi gjithashtu edhe njerëz të pajisur me vetëdije dhe me arsye, të cilat për nga vetë natyra janë të pa-



dhënieve shoqërore psh : në marrëdhëniet familjare, në pozicionin e burrit në marrëdhënie ndaj gruas dhe femijës në parimin e nderit (në të gjithë dimensionin dhe larminë e tij) në mënyrën e veshjes etj. Ndërsa esencialisht në psikikën e tij njeriu ka qendruar dhe do të qëndrojë absolutisht i paprekur që kur filloi të ekzistojë mbi tokë. Në lidhje me këtë do të flasim më poshtë. Megjithatë në qoftë se ne e shohim motivin psikologjik të individit në turmë. Në përgjithësi ai paraqitet në më shumë raste i ngjashëm me "delen" e Fromit dhe rrallë me ujkun që kërkon të dalë në krye të turmës. Ajo çfarë është më esenciale në artikullin tonë është se jeta në turmë udhëhiqet nga parimi i kaoticitetit dhe të kënaqësisë së momentit. Në kaosin e veprimtimit individuali i turmës shfryn instinktet e tij i motivuar nga parimi i kënaqësisë e trazuar kjo dhe me "justifikimin" e të qenit i pranuar në turmë. Turma është kundërtia e parimit të moralit individual. Individit duhet të "shkrihet" në turmën d.m.th të harrojë vetveten dhe në moralin e tij përfundimisht të vendosë etikën së çfarë kërkon turma ti përgjigjet asaj ose më mirë të themi ta imitojë atë në mënyrën e të sjellurit në mënyrën e të veshurit, në parimet e moralit, në vlerat dhe në mënyrën e jetesës. Ose siç thotë Fromi "individit pushon së qenuri vetvetja, përshtat për vete krejt tipin e personalitetit që i afrohet nga modelet kulturore (kupto imitimi i yjeve të muzikës etj) dhe prandaj bëhet

varura nga kopeja" Më poshtë Fromi thekson se arsyeja është ajo çfarë e individualizon një njeri nga kopeja. Ajo fut sigurinë për veprimet dhe kërkesat tona shpeshherë dhe irracionale. Më poshtë ai e kundërshton një ide të tillë dhe bën fjalë për esencën e vetëdijes njerëzore. "Por përderisa ne jemi dele as arsyeja nuk është udhëheqësi ynë i vërtetë, ne udhëhiqemi prej një parimi krejt tjetër nga parimi i solidaritetit të kopesë" N.q.s ne përpiqemi të analizojmë këtë çfarë thotë Fromi duke u mbështetur në fakte historike ne themi se ai ka të drejtë. Origjina e këtij mendimi të Fromit mendojmë se është një derivat i konceptit të "Ankthit" të filozofisë së Kierkegardit. Megjithatë tani le të shohim se çfarë thotë Herderi "Nuk ka asgjë absolute por vetëm vlera rajonale

dhe parime rrethimore. Njeriu nuk është aspak nga të gjitha kohët nga të gjitha vendet, por çdo periudhë historike dhe çdo kombi të rruzullit tokësor i përgjigjet një tip njerëzor specifik" (Alain Finkielkraut, Disfata e mendimit Bot. Marin Barleti 1999 fq 10). Ne do të thonim se realisht në qoftë se e shohim njeriun si subjekt psikik në evolucion në lidhje me kohën, me kombin, dhe me mjedisin shoqëror ku jeton ai nga njëra periudhë historike psh: mesjeta me tjetrën do të thonim me kohën e sotme. Njeriu ka evoluar. Njeriu i cili i përket periudhës së rendit skllavopronar është i ndryshëm nga njeriu që i përket periudhës së rendit bujkrob ose mesjetar dhe ky i fundit është shumë i ndryshëm me njeriun e kohëve moderne. Ndryshimi do të thonim se konsiston në sferën e marrë-

njëlloj si gjithë të tjerët ashtu siç pretendojnë ato që të jetë. Hendeku ndërmjet “meje” dhe botës zhduket. Ky mekanizëm vazhdon më poshtë Fromi mund të krahasohet me ngjyrimin mbrojtës që marrin disa kafshë. Personi që heq dorë nga uni i tij individual dhe që bëhet automat identik me miliona automatë të tjerë që e rrethojnë nuk duhet të ndihet më i vetmuar dhe i ankthshëm. Por çmimi që paguan është i lartë është humbja e unit të tij” (Erich From, Arratisja nga liria fq 141 Phoenix 1998). Pra me pak fjalë njeriu humbet vetveten, humbet personalitetin e tij dhe hidhet në vorbullën e turmës. Tani le të shohim në mënyrë mjaft të shkurtër raportin e njeriut të turmës me institucionet.” Autoriteti abstrakt i një institucioni i shprehur nëpërmjet rregullash, na lejon të konformohemi ose të rebelohemi ,ose që të dyja së bashku,vullnetit të pakuptueshëm të një individi tjetër zakonisht mund ti shkohet pas vetëm nëse kemi të bëjmë psikologjikisht me varësi, përulje, vetëposhtërim. Më poshtë autorët shpjegojnë arsyen se ideja e shtypjes vjen e ngjizet vetëm kur njerëzit fillojnë të dyshojnë se rregullat institucionale abstrakte fshehin thjeshtë vullnetin e huaj vetjak. Kjo përbën nocionin elementar apo thelbësor të tiranisë apo të sundimit arbitrar” (Filozofia dhe tranzicioni. Gashpar. M. Tomash-Ferenc Teher Agnesh Heler fq 4 Bot. Arbri 1989). Por lind pyetja,përse njeriu bashkohet me turmën ose ta themi më ndryshe sipas filozofëve idea-

listë përse njeriu është një qenie shoqërore dhe bashkohet në pjesëmarrjen shpirtërore të kolektivit njerëzor. Për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje nuk mund të mjaftojë vetëm një artikull sepse problemi është shumë planesh por në mënyrë tepër substanciale po japim dy arsyt madhore të cilat janë shtysa e domosdoshme për individin për të qenë anëtar i turmës 1)Plotësimi i nevojave për ekzistencë 2)Plotësimi i nevojave psikologjike. Në rast se njeriu do të kishte fatkeqësinë ti shmangej kolektivit njerëzor . Atëherë ai do të ballafaqohej me fenomenin e Robinson Kruzosë. Por e keqja e njeriut të përdimit qëndron në atë se “ A është lënë vallë Evropa pa një kod moral. Nuk është puna se njeriu i turmës ka flakur tej një kod tashmë antik për ta ndryshuar atë me një kod të ri ,por se në qendër të skenës së jetës së tij është vënë përpikmërisht ajo aspiratë për të jetuar pa iu përshtatur asnjë kodi moral..kur njerëzit flasin për një moral të ri ,ato thjeshtë i përkushtohen një imoraliteti të ri. Prej këtej del-thekson më poshtë Jose Gasset se do të që vërtetë naive ta akuzosh njeriun e së sotmes për mungesën e një kodi moral,sepse kjo akuzë do ta tregonte të ftohtë ose më tepër do ta lajkatonte atë. Është kjo për shkak se imoralizmi sot është shndërruar në diçka të zakonshme saqë cilado e kushdo ngre lëvdata na qiell për ushtrimin e tij” (Jose Ortega Gasset, Revolta e turmave fq 237 Bot Plejad 2003). Atëherë kush jam unë, kush je ti në turmën e pafundme të njerëzve të pe-

rëndimit. Unë dhe ti jemi ato të cilët atë çfarë e quanim të shenjtë dhe nder dje, sot e hedhim poshtë me përbuzje. Nga ana tjetër as që e ndjejmë se kemi hedhur poshtë një parim të moralit një tabu të ndërrit apo atë që është esenca e realizimit të identitetit njerëzor besimin në Zot (Xh.sh) dhe as që duam të kthejmë kokën pas dhe ta ndjejmë atë çfarë mohojmë çdo ditë atë çfarë ne deformojmë çdo ditë çfarë gënjejmë dhe mashtrujmë të tjerët dhe vetveten tonë çdo ditë. Ne nuk duhet ta lemë veten tonë të shndërrhem thjeshtë në subjekte të veprimit kaotik me bazë psikozën e interesit të momentit. Apo të veprojmë dukë u mbështetur mbi parimet e kënaqësisë dhe të vetafirmimit me çdo formë dhe mjet. Njeriu i turmës me bindje ateiste është ajo qenie e cila lëviz në kohë së bashku me turmën drejt një degradimi moral të domosdoshëm dhe drejt një deformimi dhe gjymtimi të paevitueshëm të identitetit njerëzor. Duke menduar se është stërnipi i kërmillit dhe pasardhësi i majmunit njeriu i turmës nuk ka pse të ketë ndonjë ideal në këtë jetë.....

Por misioni i tyre në këtë jetë është ai çfarë Allahu (Xh.sh) na lajmëron në Kuran duke i përcaktuar ato se “Ne Krijua shumë nga xhinët e njerëzit për xhehenem. Ato kanë zemra që me to nuk kuptojnë, ato kanë sy që me to nuk shohin dhe ato kanë veshë që me to nuk dëgjojnë. Ato janë si kafshët, bile edhe më të humbur...”

Suretu A’Rafë 179

Islami mes dijes dhe praktikës



Ajetet e para të Kuranit famëlartë që i zbritën Pejgamberit tonë, Muhamedit a.s. nga Allahu i madhëruar janë: “Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë)”. (Alak,1)

“Ai që e mësoi(njeriun) të shkruaj me pendë”. (Alak, 4)

Kjo është shpallja e parë që lartëson vlerën e pendës dhe çmon vlerën e diturisë.

Sot shumë njerëz fenë Islame e njohin vetëm për emër dhe mendojnë se mësimi i fesë është detyrë vetëm e hoxhallarëve, por jo e tyre. Disa të tjerë kanë shumë njohuri islame, mirëpo kur shikon adhurimin dhe sjelljet e tyre zhgënjehesh, pasi ata ndjekin rrugë tjetër nga ajo që kanë mësuar.

Dituria është adhurimi më i mirë pas farzeve, ndërsa kërkimi i saj është një ndërmarrje e rëndësishme. Pejgamberi a.s. në një hadith të transmetuar nga Tirmidhi ka thënë “Kush del të kërkoj dituri, është në rrugë të Allahut, deri sa të kthehet në vendin e tij”.

Rruga e diturisë është rruga për në xhenet, të cilën njeriu vazhdon ta kërkojë derisa të hyjë në të. Në një hadith të transmetuar nga Muslimi Pejgamberi a.s. ka thënë: “Allahu ia lehtëson rrugën për në xhenet muslimanit që merr rrugën për të nxënë dituri”.

Transmeton Ebu Davudi dhe Tirmidhiu nga Ebu Derda r.a. se Pejgamberi a.s. ka thënë: “Kush nis për në rrugë duke kërkuar dije, All-llahu do t’ia lehtësojë rrugën për në Xhenet. Vërtet edhe melekët ia shtijnë krahët kërkuesit të diturisë nga kënaqësia me veprën e tij. Vërtet dijetarët janë trashëgimtarë të pejgamberëve; pejgamberët nuk kanë lënë trashëgimi dinarë as dërhëmë, por ata kanë lënë për trashëgimi dijen, prandaj kush e merr, ka marrë hisen më të bollshme.”

Disa të urtë thonin: Dituria është shërbëtori i veprës, ndërsa vepra është qëllimi i diturisë, sepse po mos të ishte puna nuk kërkohet dija, e po të mos ishte dija s’do të kërkohet prej nesh puna dhe veprimi. Ai që mbledh dituri është si ai që mbledh pasuri. E mira e saj shijohet vetëm kur shfrytëzohet dhe shpenzohet.

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Zoti nuk do ta zhdu-

“Kush e studion diturinë, me të cilën kërkohet kënaqësia e Allahut, vetëm sa për të fituar ndonjë dobi në këtë botë, nuk do ta shijojë as erën e Xhenetit në Ditën e Gjykimit.”



ke diturinë duke e tërhequr atë (me dhunë) nga njerëzit, por duke i tërhequr njerëzit e ditur. Kur nuk do të ngelin më njerëz të ditur, populli do t'i zgjedhë për udhëheqës të padijshmit. Kur këto do të pyeten për ndonjë çështje, do të përgjigjen pa dijeni. Kështu do të vazhdojnë deri sa t'i arrijë shkatërrimi.” (Buhariu)

Njeriu vlen sa di dhe di sa mban mend, sepse ç'ke në xhep ta marrin, por ç'ke në tru s'ta marrin dot. Kërkoje diturinë duke ditur se sado që të kesh mësuar njohuritë tuaja nuk kanë dobi pa i kthyer në praktikë. Dituria është si pasuria, kërkuesi i saj nuk ngopet. Dallimi mes diturisë dhe pasurisë është se dituria forcohet sa më shumë që të punohet me të dhe shtohet sa më tepër që shpërndahet. Nëse paraja të mundëson të jetosh një jetë komode, atëherë dituria bën t'i fitosh të dyja jetët i lumtur dhe të mos harrosh. Siç thotë fjala e urtë: Arin e çmojnë ata që e njohin. Me sinqeritet përpiqu të punosh me atë që ke mësuar prej kësaj feje të madhe, sepse dituria është pemë, ndërsa vepra fryti i saj.

Por, sa e ndihmon të verbrin shkëlqimi i dritës së diellit kur nuk e shikon atë? Edhe Dituria që zotëron njeriu nuk e ndihmon atë përderisa ai nuk vepron në përputhje me të. Pa dije dhe pa punë, imani nuk është i plotë dhe ngjason me bilmën që nuk rritet pa tokë dhe pa ujë.

Ibni Mesudi r.a. ka thënë: “Mësoni dhe me atë që keni mësuar, veproni.” Ebu Hurejra r.a. ka thënë: “Dituria me të cilën s'punohet është si thesari që nuk shpenzohet në rrugë të Zotit.” Kurse Fudajli ka thënë: “Ajo që kërkohet prej diturisë është vepra, kurse dija është argumenti i saj.” (Transmeton Hatib El Bagdadi në “Iktidaul ilmi el amel”.)

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Mjerë për atë që s'di! Mjerë për atë që di, por nuk vepron në bazë të asaj që di (këtë e përsëriti tri herë).”

Malik Ibn Dinari ka thënë: “Ai që nuk vepron me atë që di, është si shkëmbi. Kur shiu pikon mbi të, rrëshqet (e nuk qëndron).” Sufjan Ibn Uejne ka thënë: “Dituria, nëse nuk të sjell dobi, të dëmton”, sepse bëhet argument kundër teje Ditën e Gjykimit. Në një fjalë të urtë thuhet: Trupi shërohet duke punuar, e mendja duke mësuar.

Fet'h el-Musilij ka thënë: “Nëse nuk i japim të sëmurit as ushqim, as pije dhe as ilaçe, a nuk vdesë? I thanë: Po. Tha: Gjithashtu edhe zemrës nëse i ndalohet urtësia dhe dija ajo vdesë.” Llukman Hakimi e këshillonte djalin e tij duke i thënë: “O biri im: Ulu pranë dijetarëve me thjeshtësi dhe shoqëroi ato, sepse Allahu i ringjall zemrat me dritën e urtësisë siç ringjall tokën e shkretë me ujë e shiut.”

Pejgamberi a.s.ka thënë: “Kush e studion diturinë, me të cilën kërkohet kënaqësia e Allahut, vetëm sa për të fituar ndonjë dobi në këtë botë, nuk do ta shijojë as erën e Xhenetit në Ditën e Gjykimit.” (Buhariu)

“Disa njerëz prej banorëve të Xhenetit i shohin disa në zjarr dhe u thonë: Me çfarë keni hyrë në Xhehenem, kur ne me mësimet tuaja u futëm në Xhenet? Thanë: “Ne ju urdhëronim ju, por vetë nuk vepronim.” Imam Maliku ka thënë: “Nuk përmirësohet fundi i këtij ummeti veçse me atë që u ndreq fillimi i tij”.

Pejgamberi a.s. ka thënë: “Mund të keni zili në dy raste: ndaj njeriut, të cilit Zoti xh.sh. i ka dhënë pasuri dhe ai e shpenzon në rrugën e së Vërtetës, dhe ndaj njeriut, të cilit Zoti xh.sh. i ka dhënë dituri dhe atë iu mëson edhe të tjerëve.” (Buhariu)

Këtë shkrim po e përfundojmë me një lutje që Allahu xh.sh. i ka mësuar Pejgamberit tonë, Muhamed (a.s.) dhe nëpërmjet tij të gjithë besimtarëve myslimanë. Ajo është: “Zoti im! Ma shtoj diturinë!” (Ta ha, 114)

Mania si domosdoshmëri

U ngrita në mëngjes si përherë për të falur namazin e sabahut dhe pasi mora abdest, tërhoqa ashtu si i përgjumur se-xhaden e lënë në cep të tryezës, e hapa dhe e shtrova aty përpara dhe ndërkaq bëra përgatitjen e parë për t'u lidhur në namaz. Në përfundim të namazit pasi dhashë selam siç është rregulli nuk e di se si humba në marramendjen e mendimeve dhe në një gjëndje shpirtërore aspak të natyrshme dhe të zakonshme. Mendova thellësisht lutjet që lexojmë sa e sa herë në ditë, mendova ndërkohë se si fillon "el-Fatiha-ja" dhe përpëlita më vete: "Elhamdulillah rabbil alemin...." përkthimi i së cilës është "Faleminderit Zotit të botëve..." në mendje më erdhën edhe lutje të tjera si psh ajeti i parë Kuranor "Ikra bismi rab-bikel ledhi halek" që do të thotë: "Lexo, me emrin e Zotit tënd që krijoi gjithçka" u Ndala pak në domethënien e këtij ajeti dhe fillova të mendoja edhe më thellë. Pse vallë Allahu i Lartmardhëruar e zbriti pikërisht ajetin e tij të parë me këtë thirrje në

formën e një urdhëri "Lexo!"?

Erdha në vete dhe ndërkohë vura re se minutat kishin ecur me të shpejtë. U ngrita menjëherë dhe iu drejtova tavolinës së punës, pasi natyrisht në shtëpi mbetet edhe një tavolinë në të cilën mund të lexojmë dhe shkruajmë diçka. Së pari hapa Kur'anin famëlartë dhe fillova të lexoj ajetet e para të Tij, më pas ndjeva një qetësi shpirtërore e cila më orientonte hap pas hapi dhe më kthjellonte akoma edhe më tepër. Më bente ta doja edhe më shumë këtë libër të shenjtë i cili më hapte në mendjen time një horizont të paparë për të kuptuar akoma edhe më mirë se ç'rëndësi ka ky libër dhe rrjedhimisht librat në përgjithësi.

Minutat kishin ecur si padrejtësisht në mënyrë të rrufeshme ndërkohë që drita kishte zbardhur dhe me zbardhjen e saj ishte zbardhur sado pak edhe mendja.

Kështu kaluan ditë dhe çdo mëngjes që kalonte fitonte një kuptim më shumë se ai i një dite

më parë. Kjo kohë ishte mjaft frytdhënëse, nuk e kuptoja se sa shpejt vraponte koha, doja ta mbërrija, ta kapja dhe mos ta lija të ecte aq shpejt, por ishte e pamundur. Do të lodhesha shumë për ta arritur këtë, por nuk do t'ia dilja mbanë. Nuk kishte asnjë mjet për këtë, ose të paktën për momentin nuk po më kujtohej.

Vazhdoja të ngrihesha rregullisht në faljen e namazit të sabahut sepse nga njëra anë e ndjeja si një obligim pasi kuptohet përbente një nga pesë kohët e namazeve të bëra obligim për çdo mysliman dhe myslimane dhe nga ana tjetër paralelisht me këtë dukej qartë se fryti i punës së mëngjesit ishte shumë herë më i madh se ai i pjesës më të madhe të ditës, për të mos thënë madje edhe i gjithë ditës nganjëherë. Falja e namazit të sabahut më lehtësonte trupin, më kthjellonte mendjen dhe më zgjonte një hijeshi shpirtërore të papërshekueshme. Ndjeja në vetvete sikur më plotësohej një boshllëk për të qenë i gatshëm në enigmat që të ofronte dita.

Kjo kthjelltësi më shoqëronte më pas edhe në leximin e libra-ve të tjerë të cilat ndonëse nuk kishin rëndësinë e Kuranit famëlartë gjithsesi mbanin emrin "libër"

Ndërkohë që sytë më ishin ngulur në raftin plot libra humbisja në qetësinë që më ofronte kjo pamje voluminoze, doja t'i përtërija të gjithë ashtu siç ishin, por ja që më kot lodhesha, doja t'i shfletoja të gjithë përnjëherësh, por ja që mëndja e njeriut është e kufizuar dhe e pafuqishme deri në këtë pikë. Çdo fletë e shfletuar ka një domethënie nga e cila mund të përfitosh shumë mjafton të duash të marrësh diçka.

Mendoja për momentin se çdo njeri është i apasionuar pas një fushe të caktuar, dhe rrjedhimisht edhe biblioteka e tij në një farë mënyrë mbetet e kufizuar.

Sa keq! Njeri i kufizuar! Pse vallë të jemi të tillë?

Pse vallë duhet ta pranojmë këtë kufizim?

E kemi menduar ndonjëherë se sa për qind e trurit punon? E kemi menduar ndonjëherë se sa për qind e mendjes së njeriut është në gatishmëri të plotë në çdo çast apo moment? Kemi menduar ndonjëherë si funksionon ditë-nata? Apo katër stinët? Apo se çfarë quajmë moshë të parë, të dytë apo të tretë? E kemi menduar ndonjëherë pse lindim dhe vdesim?



Duam apo nuk duam të jemi në këtë jetë? E kemi menduar ndonjëherë se pse lindëm sot dhe jo para qindra mijëra vitesh? Sa herë i bëjmë pyetje vetes: "Ah sikur të isha në këtë kohë!" dhe natyrisht që nuk marrim ndonjë përgjigje. E kemi menduar ndonjëherë se cila është pema jonë e trashëgimisë familjare apo e thënë ndryshe trangu i trashëgimisë sonë fisnore? Apo se si është ndërtuar rruzulli tokësor? Se ku ndodhet dielli që na ndriçon që nga orët e para të mëngjesit e deri në orët e vona të ditës? Pse nuk shteron ndonjëherë fuqia ndriçues e tij dhe si është e mundur që ka një diell dhe jo pesë, dhjetë apo për çdo vend nga një? E kemi menduar

ndonjëherë se përse në verë vishemi me rroba të lehta dhe në dimër me të trasha? Përse trupi ynë nuk e pranon të kundërtën? E kemi menduar ndonjëherë si qëndrojnë këto ndërtesa ashtu pa lëvizur megjithëse janë me qindra e mijëra njerëz që hipin dhe zbresin shkallët e tyre në çdo kohë të ditës? E kemi menduar ndonjëherë se si funksionon organizimi ynë megjithëse hamë e pimë çdo ditë nga mëngjesi në darkë koshientë apo subkoshientë? E kemi menduar ndonjëherë se si ndryshon truri ynë nga ai i kafshëve të tjera apo edhe i insekteve? Po sikur të kishim qenë kafshë apo insekte? Po këtë e kemi menduar ndonjëherë?



në plan të parë një mëndje të tretë e cila ecën në rrugën e përgatitur enkas për të.

Ndërsa sot kthehemi dhe vështrojmë se si bota po tronditet sepse njeriu i sotëm duket se është i papërgatitur përpara këtyre ndryshimeve njerëzore. Tek dëgjojmë burimet informative sipas statistikave të fundit 1 milion fëmijë vdesin në vit për shkak të paralindjeve apo lindjeve para kohe. Tek dëgjojmë se ndryshimet ekologjike janë mjaft të shpeshta dhe që sjellin dëme për qenien njerëzore, tek dëgjojmë për ndotjet e ambientit, apo për fatkeqësitë natyrore tashmë gjithëpërfshirëse...

Dhe njeriu i sotëm fillon të frikësohet... E ku ta dinte ky njeri i shkretë që do të vinte një kohë e tillë? Ndërsa Kurani famëlartë në shumë ajete të tij theksonte me të madhe:

“...Dhe do të vijë një kohë...”

Ndërsa në një tjetër ajet lexojmë: “Nuk ka vend që të mos kemi dërguar profetë.”

Këta njerëz u dërguan udhërrëfyes për gjithë njerëzimin dhe Allahu i Lartmadhëruar i la njeriut të sotëm dy shtylla të rëndësishme për të vazhduar më tej: Kuranin dhe Synetin dhe i siguroi se do të ishin të palëkundur përsa kohë që të mbështeteshin në to, por ç’ndodhi?

.....

I kthehem vetëdijes sime për

Dhe mendimet vazhdojnë pa-reshtur

Prandaj a mund t’i mësojë të gjithë këto një mëndje e kufizuar? A mund të jetë e gatshme një mendje e kufizuar t’u japë përgjigje të gjitha këtyre pyetjeve?

Tek shfletojmë faqet e historisë nuk ka se si të mos na bien në sy mundimet dhe sakrificat e sa e sa njerëzve mendjendritur që nuk njohën lodhje vetëm për të qenë në shërbim të njerëzimit dhe të fshehtave që ofron koha. Punuan ditë e natë, dimër e verë pa përtuar vetëm e vetëm t’u shërbejnë njerëzve. Udhëtuan me ditë, javë, muaj dhe vite për të qenë sa më afër

dijes, Një shembull tipik është edhe historia e sahabeve të Pejgamberit tonë Muhamedit (a.s) të cilët nuk pushuan së reshturi të ishin sa më pranë tij për të marrë udhëzimet e tij që ne sot t’i kemi në dorë dhe t’i vëmë në jetë. Sa e sa dijetarë i munguan dritës së diellit, dashurive njerëzore për të lënë gjurmë në histori me veprat e tyre tepër dinjitoze.

Të mendojmë për një çast mundimet nëntëmujore të një nëne për të nxjerrë në dritë një jetë. Dhe natyrshëm ky është vetëm fillimi pasi këto sakrifica janë të përgjeshme. Të mendojmë sakrificat e një babai për të siguruar mbijetesën dhe në përfundim dy mëndje të ndritura nxjerrin

Ë'u shkëputur nga kjo pjesë e bukur për të ecur në hapat e të përditshmes dhe për të prekur gjithë këtë realitet të lartpërmen-ndur. Nuk mjafton një ditë, javë apo muaj dhe natyrisht kanë për të kaluar vite, por gjithsesi ajo ndërgjegje dhe përgjegjësi individuale më fton të jem përherë pjesë e saj, të jem pjesë e Kuranit dhe e synetit, të jem pjesë e namazit të sabahut dhe kuptohet edhe e namazeve të tjera. Kjo qetësi dhe kthjelltësi që gjej këtu më ndihmon të shfletoj më lehtë librat e tjerë për t'u përgatitur më mirë në mësimet e jetës. Kjo më bën të pranoj kufizimin mendor, por duke kuptuar më së miri se ndërgjegjja kërkon gjithanshmëri të madhe për të kuptuar qenien dhe ekzistencën tonë në këtë jetë. Kjo më bën të kuptoj më së miri fjalën e urtë popullore: "Koha është flori" ashtu sikurse bëhem akoma edhe më i vetëdijshëm kur kuptoj se pse Allahu i Lartmadhëruar betohet në kohën duke thënë: "Vel Asr! Pasha Kohën!"

Kështu duke vlerësuar në mënyrën më të mirë të mundshme kohën e parë të ditës, atë të mëngjesit dhe duke ecur përpara me të njëjtin ritëm që të ofron urtësia hyjnore kthehesh në mbrëmje i ngarkuar me përgjegjësitë e ditës dhe bashkë me to edhe me shumë kënaqësi duke menduar se sa i dobishëm ke qenë sot për shumë njerëz dhe kështu, me këtë fisnikëri, vazhdon ta kryesh detyrën tënde

njerëzore.

Në çdo moment të ditës kërkon të hasesh me fletushkat e librave si udhërrëfyese për vazhdimësinë tënde. Atëherë e kupton se sa njeri ishe më parë. Nëse kërkon të jesh përsëri i tillë dhe të fitosh më shumë nga emri "njeri" vazhdon të shfletosh dhe të grumbullosh pasi e nesërmja të gjen me të papritura të shumta. Vetë i dërguari i Allahut Muhamedi (a.s) pati thënë:

"Nuk është prej nesh kush i ka dy ditë njëlloj"

Kështu, njeriu, dita ditës e kupton se sa afër është me botën ku jeton, por sa larg është në të njëjtën kohë, sa afër është kur çdo ditë bëhet pjesë e shkencës dhe horizonteve të librave, por në fakt është shumë larg kur kupton se teoria dhe praktika në shumë raste nuk dalin të barabarta. Dhe në të shumtën e rasteve pëson një lloj zhgënjimi duke kërkuar shmangien nga kjo detyrë, por më pas e kupton se duhet pakëz durim për të arritur atë që dëshirohet pasi vetë Allahu e thotë në Kur'an: "In-nallahe mea-s Sabirin" që do të thotë "Allahu është me të duruarit" Nisur nga kjo kthjellohet edhe më shumë dhe kërkon të ecë përsëri përpara.

Mos vallë e gjitha kjo është një mani? Po e vërtetë. Një mani e njeriut për të fituar identitetin e tij, është një lloj manie shumë interesante dhe më se e domosdoshme për të kuptuar qëlli-

min e ardhjes në këtë jetë. Nëse në jetë i vëmë vetes disa objektiva për të realizuar dhe gjatë rrugëtimit shohim se aspiratat tona janë në përmbushje, nëse qëllimet që i kemi vëmë vetes janë në përputhje të plotë me udhëzimet e Kuranit dhe jetën profetike, nëse të përditshmen tonë dëshirojmë ta planifikojmë në mënyrë të atillë që çdo e djeshme të mos jetë një e sotme dhe çdo e sotme mos të jetë një e nesërme, nëse individualiteti ynë formohet në rritje e sipër duke kuptuar fazat më të rëndësishme të jetës dhe nëse të gjitha këto na i ofron më së miri një edukim dhe arsimim më i mirë dhe më i mirëfilltë, atëherë pse mos ta kërkojmë një mani të tillë?

Nëse sot kërkojmë të jemi të suksesshëm le të mos harxhojmë shumë kohë, por të jemi të gatshëm të shfrytëzojmë në maksimum kohën e dhënë, të jemi përherë pjesë e literaturës ku në njërën anë të kemi Kuranin dhe synetin e profetit ndër-sa në tjetrën teknologjinë bashkëkohore dhe të jemi të sigurtë se individualiteti ynë do të jetë krejtësisht ndryshe nga ai i të tjerëve. Të jemi të sigurt se do jemi në të kërkuarit për të tjerët për sa kohë që të kemi në dorë këto dy armë të fuqishme.

Dhe kush nuk do të dëshiron-te të mos ishte pjesë e një manie të tillë!

Ajete

"Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Zoti yt është më bujari! Ai e mësoi (njeriun) të shkruajë me pendë. I mësoi njeriut atë që nuk e dinte."

(Alak: 1-5)



"Zoti im! Ma shto diturinë!"

(Ta-Ha: 114)



"Thuaj: "A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?" Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim."

(Zumer: 9)



"Ai është që arabëve të pashkolluar u dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre që t'ua lexojë ajetet e Tij, t'i pastrojë ata, t'ua mësojë librin dhe sheriatin, edhe pse më parë ata ishin në një humbje të dukshme."

(Xhuma: 2)



"Ai është që ta zbriti librin ty e që në të ka ajete të qarta dhe ato janë bazë e librit, e ka të tjerë që nuk janë krejtësisht të qartë (muteshabih). E ata, që në zemrat e tyre kanë anim kah e shtrembëta, ata gjurmojnë atë që nuk është krejt e qartë për të shkaktuar huti, e kinse kërkojnë komentin e tyre. Po, pos Allahut askush nuk e di domethënien e tyre të saktë. Dijetarët e pajisur me dituri thonë: "Ne u kemi besuar atij (atyre që janë të paqarta), të gjitha janë nga Zoti ynë"! Por këtë e kuptojnë vetëm ata që janë të zotët e mendjes."

(Ali Imran: 7)



"E, edhe për ta vërtetuar të dijsmit se me të vërtetë ai (Kurani) është i vërtet prej Zotit tënd dhe kështu t'i besojnë atij (Kurani) dhe (zemrat e tyre) të binden ndaj tij. E All-llahu patjetër do t'i udhëzojë ata që besuan (përqafuan) në rrugën e drejtë."

(Haxh: 54)



"Këta janë shembuj që Ne ua sjellim njerëzve, po këta nuk i kupton kush pos dijetarëve."

(Ankebut: 43)



"Edhe nga njerëzit, nga gjallesat, nga kafshët po ashtu ka të ngjyrave të ndryshme. Po Allahut ia kanë frikën nga robërit e Tij vetëm dijetarët, All-llahu është mbi gjithçka, është mëkatfalës."

(Fatir: 28)



"O ju që besuat, kur t'ju thuhet: zgjerohuni (bëni vend) në vend ndeje, zgjerohuni, se All-llahu bën zgjerim për ju, e kur t'ju thuhet: ngrihuni! Atëherë ju ngrihuni, All-llahu i lartëson ata që besuan prej jush, i lartëson në shkallë të lartë ata të cilëve u është dhënë dituri. All-llahu është i njohur mirë me atë që punoni."

(Muxhadele: 11)



Hadithe

"Kush del të kërkoj dituri, është në rrugë të Allahut, deri sa të kthehet në vendin e tij"



(Tirmidhiu)

"Allahu ia lehtëson rrugën për në xhenet myslimanit që merr rrugën për të nxënë dituri"



(Muslimi)

"Mund të keni zili në dy raste: ndaj njeriut, të cilit Zoti xh.sh. i ka dhënë pasuri dhe ai e shpenzon në rrugën e së Vërtetës, dhe ndaj njeriut, të cilit Zoti xh.sh. i ka dhënë dituri dhe atë ia mëson edhe të tjerëve."



(Buhariu)

"Ndër shenjat e kiametit janë: zhdukja e diturisë, shtimi i paditurisë, pirja e pijsve dehëse"



(Buhariu)

"Kur vdes njeriu, veprimtaria e tij ndërpritet, përveç në tri raste: nëse ka lënë pas vetes lëmoshë (sadaka) të përhershme, dituri të dobishme (libër, zbulim etj) ose një fëmijë i cili lutet për të."



(Muslimi)

Ebu Hurejra transmeton se Profeti a.s. ka thënë: "Për atë i cili nisat në rrugën e kërkimit të diturisë, Allahu do t'ia lehtësojë atij rrugën për në parajsë."



(Muslimi)

Transmeton Tirmidhiu nga Ebu Umame se Profeti a.s. ka thënë: "Një i ditur është i ngritur mbi një besimtar (të zakonshëm) aq sa unë jam i ngritur mbi më të ulëtën ndër ju." Dhe shtoi: "Allahu, engjëjt e Tij dhe të gjithë ata që janë në qiell dhe në tokë, edhe milingonat në zgavrat e tyre e peshku në det, kërkojnë bekimin e atyre që i udhëzojnë njerëzit në diturinë e dobishme."



(Tirmidhiu)

Transmetojnë Ebu Davudi dhe Tirmidhiu se Ebu Derda tregon se e ka dëgjuar Profetin a.s.: "Ulematë janë trashëgimtarët e Profetëve dhe Profetët nuk lënë trashëgim ndonjë dërrhem ose dinar, por vetëm dituri. Ai i cili merr dituri, ai merr një pjesë të madhe."



(Ebu Davudi dhe Tirmidhiu)



Të lexosh me ëndje fjalën më supreme

Fjalët dhe zërat kanë fituar një madhështi me tingujt e Kuranit nisur nga urdhëri i parë i Allahut të Lart-madhëruar. (Lexo, me emrin e Zotit tënd Krijues) I dërguari i Allahut ka thënë:

-Zbukurojeni Kuranin me zërat tuaj (Lexojeni atë me zërat tuaj bukur dhe saktë).



Duke qenë se fjala më e bukur është vetë Kurani, edhe madhështia e zërit të njeriut shfaqet nëpërmjet Tij.

Çdo tingull të ngop, por ai i Kuranit asnjëherë!..

Aroma e xhenetit është në muzikalitetin e Tij.

Edhe qetësia e gjynahbërësve dhe e të përvuajturve qëndron në ilaçin shërues të shpirtave të tingujve të Kuranit. Inkurajuesit ushqehen përherë nga tingujt e tij. Gjuha e Xhenetit është gjuha e Tij.

Pasi Pejgamberi (a.s) tha: “Zemrat ndryshken si hekuri” u pyet se cila ishte lënda pastruese e tyre dhe ai iu përgjigj:

-Leximi i Kuranit dhe përkujtimi i vdekjes.

Kur Pejgamberi (a.s) në një tjetër rast tha: “Jepuni syve rrisht nga adhurimi” u pyet: “Çfarë është rrishtu i syve o i dërguari i Allahut?”, ai tha:

“Allahu Teala vë lexuesit e Kuranit në raundin e parë të atyre që meritojnë fitesën e përjetshme.

“Kush lexon librin e Allahut, fal namazin dhe shpenzon nga pasuria e tij për hir të Allahut fshehtazi apo haptazi mund të kërkojë një fitim që nuk do t’i sjellë kurrë dëm”

“Allahu ua jep të plota shpërblimet e tyre dhe u jep shumë më tepër nga dhuntitë e veta. Padyshim që Ai është shumë falës dhe dhurues.” (Fatir, 29-30)



“Besimtarë të devotshëm janë ata të cilëve u dridhen shpirtat kur përmendet Allahu, u rritet besimi kur lexohen ajetet e Allahut dhe vetëm Atij i përulen.”

(Enfal, 2)



“Ata netëve ulen në sexhde dhe lexojnë ajetet e Allahut” (Al-i Imran, 113)

Leximi i ajeteve të Allahut ua shton besimin.

“Besimtarë të devotshëm janë ata të cilëve u dridhen shpirtat kur përmendet Allahu, u rritet besimi kur lexohen ajetet e Allahut dhe vetëm Atij i përulen.” (el-Enfal, 2)

Lidhur me ndikimin e fjalës së Allahut një rol të posaçëm luan edhe bukuria e zërit po aq sa edhe kiraati. Në fakt ashtu si edhe fjalët për të folurën njerëzore mund të kenë kuptime të ndryshme për shqiptime të ndryshme në disa situatë ndikimi i tyre rritet e në disa të tjera ulet. Mënyra e të kërkuarit të një lypsari qartësohet jo vetëm me fjalët që zgjedh, por edhe me mënyrën e shqiptimit të tyre. Nuk ka dyshim se çdo lloj komande para një luftimi ndikohet dhe merr forcë nga mënyra e të shprehurisë të fjalëve që nxisin ushtarët për luftë. Edhe faktori që sjell grupin e meherit dhe muzikalitetin e vet është pikërisht kjo forcë ndikuese.

Kjo cilësi që i përket fjalëve të thjeshta të njeriut është e qartë se ka një rëndësi të madhe për shpalljen hyjnore, pra Kuranin që është edhe një fjalë e vetme. Kush e di, ndoshta vetëm për këtë dallim leximi i Kuranit është bërë synet ndërsa dëgjimi farz. Kjo është edhe arsyeja që leximi i Kuranit ka zënë një vend të rëndësishëm në mesin e shkencave Islame duke u shfaqur si një shkencë e posaçme nën titullin “Shkenca e kiraatit” njëlloj sikurse imamët e medhhebëve.

Ajo për të cilën kujtohet një nga Pejgamberët që i është dhënë edhe libri, Davudi (a.s), megjithë cilësitë e tjera që ka dhe që njihet edhe në historinë e njerëzimit si “Davudi” është zëri i tij i bukur.

Tregohet edhe në Kuran që zëri i veçantë që lexonte fjalën hyjnore e cila është fjala më e bukur i bënte edhe zogjtë dhe malet që bënin tesbih t’i përulëshin Davudit.

Edhe kafshët e egra dhe qeniet e tjera merrnin pjesë në tesbihatën e tij.

Leximi i fjalës së Allahut padyshim që është një nga adhurimet më frytdhënëse. Prandaj është një domosdoshmëri që të lexohet sipas rregullave. Allahu thotë:

“Lexoje Kuranin gjermë për gjermë.” (Muzemmil, 4)

Nga ana tjetër, përveç leximit të rregullt të Tij është mjaft e rëndësishme edhe dëgjimi në qetësi. Kjo pasi leximi i Kuranit është synet ndërsa dëgjimi farz. Në një ajet Kuranor thuhet:

“Kur të lexohet Kurani dëgjojeni atë, që mbi ju të bie mëshira!” (el-A’raf, 204)

Si gjatë namazit ashtu edhe gjatë adhurimeve të tjera ndërkohë që lexohet Kurani është e nevojshme që ta dëgjojmë me vëmendje dhe qetësi për të kuptuar mirë domethënien e Tij, për të marrë mësimet e duhura dhe për të vepruar sipas parimeve të Tij.

Mbajta e qetësisë ndihmon në të dëgjuar, të



dëgjuarit mirë ndihmon në maturi, matura forcon besimin dhe punën duke u bërë shkak për mëshirën dhe mirësitë hyjnore.

I dërguari i Allahut pëlqente që të dëgjonte këndimin e Kuranit nga dikush tjetër, madje nganjëherë urdhëronte Ibn-i Mes'udin që të lexonte dhe e dëgjonte atë me një ndjesi mjaft të madhe. Një herë kishte dëgjuar Ibn-i Mes'udin tek lexonte Kuran dhe sytë i ishin mbushur me lot.

Këtë ngjarje Abdullah bin Mes'ud e transmeton në këtë formë:

-Një herë i dërguari i Allahut më urdhëroi:

-O Ibn-i Mes'ud! Më lexo Kuran! Ndërsa unë i thashë:

-O i dërguari i Allahut! Si mund t'jua lexoj ndërkohë që Kurani u është zbritur juve?

Më pas i dërguari o Allahut m'u përgjigj:

-Mua më pëlqen ta dëgjoj Kuranin edhe nga dikush tjetër.

Unë fillova të lexoj suren Nisa dhe sapo mbërrita në ajetin 41 i dërguari i Allahut tha:

-Mjafton!

34

Në atë çast vura se sytë i kishte të përlotur, po qante. (Buhari)

Një tjetër hadith tregon:

Një herë në darkë vonë Usejdi po lexonte ëmbëlsisht gërmë për gërmë suren Bakare apo suren Kehf. Edhe kalin e kishte të lidhur pranë. Ndërkohë që po lexohej Kurani kalin filloi të tundej. Usejdi pushoi dhe ndërkaq edhe kalin u qetësua. Vazhdoi përsëri të lexonte dhe kalin përsëri filloi të tundej. Usejdi pushoi edhe kalin pushoi. Sapo filloi Usejdi të lexojë kalin përsëri filloi të lëvizte. Në këtë kohë Usejdi e la mënjatë Kuranin. Edhe i biri jahja ishte shtrirë aty pranë kalit. E tërhoqi të birin pakëz prapa që kalin most a dëmtonte. Në këtë kohë ngriti kokën lart dhe vuri se brënda një mjegulle që i ngjante hijes së një reje të bardhë shkëlqenin disa yje sitë ishin kandila. Kur zbardhi dita shkoi te Pejgamberi për t'i treguar ndodhinë. i dërguari i Allahut i tha:

-Lexo o biri i Hudajrit, lexo o biri i Hudajrit!

Usejdi iu përgjigj:

-O i dërguari i Allahut! U frikësova se mos kalin do i bënte ndonjë të keqe Jahjas. Pasi fëmija ishte pranë kalit. Më pas ngrita kokën lart dhe

vura re të ndriçonin disa yje si në formën e kandilit brenda një mjegulle të bardhë që i ngjante një reje të bardhë. Më pas u shpërndanë drejt qiellit.

I dërguari i Allahut e pyesi:

-E di ti se ç'janë ato?

Usejdi iu përgjigj:

-Jo!

I dërguari i Allahut vazhdoi:

-O Usejd! Ata janë melekë që të janë afruar për të dëgjuar Kuran. Sikur të kishe vazhduar të lexoje Kuran ata do të të qëndronin deri në mëngjes. Njerëzit i shohin pasi ata nuk iu shmangen njerëzve.(Buhari)

Hadithi shpreh atë që nga leximi i Kuranit emocionohen melekët madje edhe kafshët. Kush e di si i shfaq të fshehtat Kurani një shpirti të shpëtuar nga turbullirat dhe të brymosur me rrezatime hyjnore?

Ndjesia e Omerit të vë në mendime. Ai thotë:

“Për dymbëdhjetë vjet e kam bërë hatme suren Bakare, më pas kam prerë edhe një kurban për falënderim.”

Leximi i Kuranit nuk ishte thjeshtë vetëm shqiptim i fjalëve. Ky lexim bëhej duke i kushtuar kujdes të veçantë urtësive dhe të fshehtave të Kuranit dhe duke i perceptuar e jetuar mesazhet hyjnore të Tij. Kjo është e vetmja mundësi

Një shembull i ngjashëm i këtij leximi është edhe ky:

Ebu Bekir Verrak kishte një djalë të vogël. Për të mësuar Kuranin merrte mësim nga një mësues. Një ditë u kthye herët nga shkolla ashtu siç ishte duke u dridhur. Ebu Bekir Verrak i habitur kur e pa të birin e pyeti

-Ç'ka ndodhur biri im, përse ke ardhur kaq herët sot nga shkolla?

I biri, me një fytyrë të verdhë sikurse gjethet e vjeshtës dhe me frikën e Allahut të brymosur tashmë në shpirtin e tij i drejtohet duke iu përgjigjur:

-Baba! Sot mësuesi na mësoi një ajet. Kur kuptova domethënien fillova të dridhesha!

I ati e pyeti:

-Biri im, cili na qënka ky ajet Kuranor?

I vogli filloi të lexonte:

“Nëse ju mohoni, si do të mbroheni në një ditë që fëmijët do t'i bëjë pleq?” (Muzemmil, 17)

Fëmija u sëmur nga domethënia e këtij ajeti. U bë për shtrat. Nuk kaloi shumë dhe vdiq.

Babai Ebu Bekir Verrak u emocionua shumë nga një ngjarje e tillë. Aq shumë sa që shpesh shkonte në varrin e të birit dhe ashtu i përletur thoshte me vete:

-O Ebu Bekir! Biri yt vdiq nga frika e Allahut me një ajet që dëgjoji nga Kurani. Ndërsa ti ke kaq kohë që lexon Kuran dhe nuk frikësohesh nga drejtësia hyjnore as sa një fëmijë!..

Ja pra, Kurani është një oqean urtësish dhe të fshehtash që dridh qoftë edhe shpirtrat e vegjël. Ky ajet pasqyron mjaft qartë pafundësinë e dijes së Allahut, pafundësinë e haxhmit shpirtëror të Kuranit dhe madhësitinë hyjnore.

“Sikur të gjithë drutë në tokë të jenë lapsa dhe sikur deti t'i shtohen edhe shtatë dete (e të jenë me ngjyrë), nuk do të mbaroni fjalët e All-llahut (do të shterroheshin detet, do të soseshin lapsat, e jo mrekulitë e Zotit). All-llahu është ngadhënjyesi i urtë.”(Llukman, 27)

Vetë njeriu merr pjesën që i takon nga ky det i thellë aq sa pranon edhe gjëndja shpirtërore e



tij. Por edhe kjo është aq sa edhe një milingonë mund të marrë nga një det i tillë.

Fuqi e pamjaftueshme për njeriun...

E vetmja rrugëzgjdhje është mbështetja në dhuntinë e Allahut!

E fshehta e këtij hadithi është me të vërtetë e mahnitshme:

“Kush e njih vetveten, aq e njih edhe Zotin.”

Mevlana thotë:

Të shkruash Kuranin mjafton edhe pak bojë shkrimi, por të shkruash të fshehtat e Tij nuk mjafton as një det i pafund!...

Për rrjedhojë hafizi i vërtetë i Kuranit është ai që kënaqet me leximin e Tij, që jeton me parimet e Tij, edukohet me edukatën e Tij dhe formohet me urtësinë e Tij. Nisur nga hafizët që kanë cilësi të tilla tokës i është dhënë urdhëri: “Mos e tret trupin e tij!”

Një nga miqtë e ngushtë të Allahut Mahmud Sami Ramazanoglu transmeton se ka qenë dëshmitar i një rasti në Adana ku për shkak të hapjes së një rruge të re, pas tridhjetë vitesh i është hapur varri një hafizi me cilësitë e lartpërmendura dhe ndërkaq është vërtetuar se trupi i tij nuk ishte prishur aspak, përkundrazi edhe qefini qëndronte ashtu i padëmtuar.

Një nga cilësitë e Allahut siç ka ndodhur edhe tek pejgamberët e tjerë ka qenë leximi i Kuranit dhe nisur nga kjo begati për bashkësinë e Tij, ka thënë:

-Më i dobishmi në mesin tuaj është ai që e mëson dhe ua mëson të tjerëve Kuranin.

-Kush e lexon dhe e mëson përmendësh Kuranin është më i dobishmi në mesin tuaj.

Kurani është një fjalë superiore, dhurata më e madhe e pakrijuar që i është dërguar njerëzimit nga ana e Allahut. Lidhur me këtë i dërguari i Allahut ka thënë:

-Kurani është më me vlerë nga çdo gjë tjetër pos Allahut. Superioriteti që ka Kurani ndaj fjalëve të tjera është sikurse superioriteti që ka Allahu i Lartmadhëruar ndaj krijesave të veta. (I pashembullt, i pakufijshëm, i pafund) (Tirmidhi, Darimi, Bejhaki)

Fjalën hyjnore duhet ta lexojmë me një shpirt të zgjuar sepse Kurani hapet sipas zemrës së atij që e lexon. i dërguari i Allahut ka thënë:

-Besimtari që lexon Kuranin është sikurse fruti aroma e të cilit edhe shija janë të këndshme. Besimtari që nuk lexon Kuranin është si hurma, nuk ka aromë, por shija është e këndshme. Mosbesimtari që lexon Kuranin i ngjan borzilokut, me aromë të këndshme por me shije të hidhur. Mosbesimtari që nuk lexon Kuranin i ngjan shalqirit të Ebu Xhehlit pa aromë dhe pa shije.

Në një tjetër hadith për ata që lexojnë Kuranin në mënyrë të pavetëdijshme thuhet:

-Ata lexojnë Kuran por e lexuara e tyre nuk kapërdihet. Nëpërmjet të cilit kuptohet se të lexuarit në këtë mënyrë e Kuranit nuk ka asnjë dobi.

Një lexim i tillë e çon lexuesin në xhehenem. Për të tillë lexues Allahu thotë:

-A nuk e mendojnë ata Kuranin në detaje? Mos vallë shpirtat e tyre janë të vulosura? (Muhamed,24)

Robërit me shpirt të pasur që i mendojnë thellë këto çështje marrin shumë hise të mëdha. Duhet të mendojmë që kur është zbritur ajeti Kuranor: “Për ata që All-llahun e përmendin me

përkujtim kur janë në këmbë, kur janë ulur, kur janë të shtrirë dhe thellohen në mendimie rreth krijimit të qiejve e të tokës (duke thënë): „Zoti ynë, këtë nuk e krijoje kot, i lartësuar qofsh, ruanaprej dënimit të zjarrit!” (Al-i Imran, 191) i dërguari i Allahut ka zbardhur duke qarë me lot në sy

Prandaj lotët e besimtarëve që dalin si pasojë e frikës nga Allahu janë si bukuria e netëve të përkohshme, yjet e netëve të errëta dhe lulet e kopshteve të xhenetit. I dërguari i Allahut ka thënë:

-O Zoti im! Të mbështetem Ty prej syve që nuk përloten!

Kjo është edhe arsyeja që të pavetëdijshmit që nuk e lexojnë me kujdes dhe vëmendje Kuranin njohin anën e jashtme të jetës, por nuk njohin të vërtetat e brendshme dhe botën e thellë shpirtërore. Ata vrapojnë pas kënaqësive të kësaj bote ndërkohë janë të pavetëdijshëm për urtësitë dhe rezultatet.

Ata e shfrytëzojnë në mënyrë të pavetëdijshme sofrën e kësaj bote ndërkohë që nuk njohin të zotin e kësaj sofre.

I varrosin të afërmit ndërkaq nuk dinjë se ç'bëhet në botën e poshtme. Ata nuk e kuptojnë gjuhën e selvive.

Kur hanë ndonjë shuplakë nga fatkeqësitë e kohës kërkojnë vend ku të futen duke i gjykuar këto si “ngjarje natyrore”

Sa e habitshme është që jetojnë në pasurinë hyjnore dhe nuk njohin të zotin.

Të tillët janë fatkeqët e dy botëve shpirtrat e të cilëve janë të zinj katran.

Ndërsa besimtarët, zemra e të cilëve është

e mbushur me dritën hyjnore janë gjithnjë në meditimin e të vërtetave hyjnore Fjala hyjnore që lexojnë rrënjoset në shpirtrat e tyre

-Je rob i Allahut; jeton në pasurinë e Tij; merr mirësi nga frytet e Tij; Përfshihu në urtësitë dhe të fshehtat e Kuranit dhe udhëto me shpirt të pastër drejt Zotit tënd!...

Ata që jetojnë me Kuranin janë të vetëdijshëm për robërinë ndaj Zotit. Falënderojnë për mirësitë që u janë dhënë dhe jetën e tyre të përkohshme e kthejnë në pasuri për jetën e përjetshme.

Pejgamberi dhe Kurani janë dy burime drite që Zoti rrezaton tek robërit e vet.

Nisur nga kjo për ata që marrin pjesë nga jeta Muhamedane Kurani është gjuha e vendit, begatia e shpirtave dhe thesari shpirtëror.

Ka tre gjëra tek të cilat shfaqen plotësisht cilësitë e Allahut: Gjithësia, Kurani dhe njeriu...

Në gjithësi kemi veprimtarinë, Kurani përbën fjalën ndërsa njeriu përbën farën. Siç mund të jetë e vobektë një botë pa njerinë e tillë është edhe njeriu pa Kuran.

Mevlana thotë:

Kurani është cilësi e pejgamberëve. Nëse e lexon Kuranin me qetësi dhe e praktikon Atë pandeh se je takuar me Pejgamberët. Kur lexon ndodhitë e Pejgamberëve fillon ta ndjesh veten ngushtë.

-Zoti im! Mos na e ndaj zemrën nga drita e Kuranit dhe dashuria e Allahut.

Amin!...

KU JANË TRETUR NXËNËSIT E ULEMASË SË SOTME?

Ulemaja e gjallë është zëvendësuar me libra islamë të pajetë. Sikurse librat islamë paraqesin shkronja të vdekura mbi letër, ashtu edhe besimi ynë është bërë petkë i pajetë mbi trupin tonë. Të pajetë janë bërë edhe mësuesi / alimi edhe nxënësi / talibi.

ÇKA QUAJMË 'ALIM DHE ÇKA QUAJMË TALIB

Fjala *ulema'*, që e njeh populli ynë, buron nga gjuha arabe. Ndonëse përdoret në njëjës (p.sh. Filani është *ulema'* i madh) forma e kësaj fjale është në shumës (i parregullt). Njëjësi i kësaj forme është po ashtu trajta e njohur ndër ne, fjala *alim*. Në gjuhën shqipe do të thotë: dijetar, shkencëtar, i ditur. Në fjalorin e përditshëm të muslimanëve shqiptarë por edhe të popujve ballkanikë fjala *alim / ulema'*, nuk ka kuptimin e çfarëdo dijetari. *Alim / ulema'*, për shembull, nuk quhet gjeografi, gjuhëtari, fizicenti etj., por *alim / ulema'* është imami, mual-limi, hatibi, hoxha, personi i cili fjalët e tij i konfirmon me veprat e tij, respektivisht *alim – ulema'* quhet personi të cilit ndonjëherë fjalët mund t'i mungojnë, por jo edhe veprat. *Alim* është ai i cili pandërprerë mëson dhe i thëllon njohuritë, pandërpre-

rë e shpërndanë diturinë dhe sakrifikohet për të – të gjitha në emër të Allahut. *Alimi* në rast mossuksesit e fajëson veten e jo të tjerët, kurse suksesin nuk ia përshkruan vetvetes por ia përshkruan vetëm Allahut sh. sh.. *Alimi* kontributin e tij në dituri e quan vetëm si një detyrim të tij, vetëm si një obligim të tij ndaj të tjerëve, ndaj Krijuesit dhe nuk e përdorë si provë që të tjerët t'i nënshtrohen. Ky është personi i cili me fuqi të pranishme edhe pse të padukshme e tërheq vëmendjen rreth vetes dhe nxit respekt të natyrshëm te të tjerët. *Alimi* tubon nxënës, të cilët i udhëzon në rrugë të vërtetë, i udhëzon në fe të mirëfilltë.

Atë të cilin e mëson *alimi* (mësuesi) quhet *talib*. Edhe kjo fjalë buron nga gjuha arabe dhe paraqet njëjësin e fjalës *tul-lab*. *Talib* është ai i cili kërkon dituri. Ky është nxënësi, nxënësi i medresesë, shkolla e cila e ka bërë atë dijetar dhe mësues. *Talib* është ai i cili është i etshëm për dituri dhe assesit nuk pajtohet me sasinë e dijës së arritur, sikur që haxhiu nuk mjaftohet me sasinë e ujit të pirë të Zem Zemit. *Talib* është ai nxënës i cili gjatë jetës së tij e ka kuptuar rëndësinë e mësuesit, i cili e ka kuptuar se shoqëria, para

së gjithash, mësuesin e bënë besimtar më të mirë dhe vetëm pastaj edhe njeri, bir, vëlla, bashkëshort dhe baba.

MËSUESIT E MIRË DHE NXËNËSIT E MIRË

Mësuesit e mirë e të mëdhenjë gjatë historisë kanë pasur edhe nxënës të mirë e besnikë. Pas një kohe këta nxënës bëheshin dijetarë të mirë. Këta dijetarë të hershëm e vlerësuan drejtë emanetin e pranuar për mësimin e diturisë, e transmetuan dijen dhe e ndanë zekatin për diturinë e vet ndër nxënësit e tyre besnikë. Nxënësit besnikë e të zellshëm, sërish, pas një kohe bëheshin mësues të mirë dhe kështu ky zinxhir përsëri-tej.

Në histori kemi mësues dhe nxënës të njohur. Mësuesi Sokrati e kishte për nxënës Platonin. Platoni e kishte për nxënës Aristotelin. Ata mësuan nga mësuesit e tyre, i ndoqën hap pas hapi dhe një ditë u bënë edhe më të mëdhenjë se mësuesit e tyre. Nga mësuesit e mëdhenjë para së gjithash duhet mësuar si të bëhemi nxënës të mirë dhe kjo mund të mësohet. Bota ka pasur edhe shumë mësues të tjerë të mëdhenjë që

me këtë rast nuk janë përme-
ndur. Ata kanë dhënë kontribut
në qytetërimin botëror dhe e
kanë vendin e tyre meritor. Por
si duhet të bëhemi mësues të
mirë dhe të respektuar, kjo nuk
mund të mësohet, por kjo du-
het të fitohet, të arrihet.

Mirëpo, nxënësi më i madh
është ai të cilin e ka mësuar
Allahu xh. sh., e ai është Mu-
hammedi a.s.. Burimi i mësi-
mit të Pejgamberit të Allahut
nuk është idhujtaria greke, as
ateizmi budist, as dualizmi za-
ratustrian, as idhujtaria greko-
romake perëndimore por
burim i mësimi të tij ishte vetë
Allahu i madhërishtëm. Ai ishte
nxënës i devotshëm dhe këm-
bëngulës kundrejt Allahut xh.
sh., por ai është mësues i jash-
tëzakonshëm dhe madhështor i
shokëve të tij të shumtë, e sido-
mos mësues i Ebu Bekrit, Ome-
rit, Osmanit e Aliut, Allahu
qoftë i kënaqur me ta. Ai ishte
mësues me vlera të jashtëza-
konshme, dritë mbi drita dhe
këtë dritë ua mbëltoi shokëve të
tij, ua mbëltoi bindjen se si t'i të
bëhen nxënës të mirë, si ta arrij-
në respektin, autoritetin dhe
nderin e mësuesit dhe si të tillë
në të gjitha anët e botës e trans-
metuan porosinë e Allahut.

NXËNËSI BËHEJ MËSUES ...

Pasuesit më të afërm të Mu-
hammedit a.s., as'habët si Ebu
Bekri, Omeri, Osmani, Aliu,
Abdullah ibn Abbasi, Ebu Hu-
rejre dhe as'habë të tjerë nga
plejada e tyre e më të mirëve,
të cilët nuk ndaheshin nga Mu-
hammedi a.s., ishin talibët (nxë-
nësit) e vërtetë, gjurmuesit e
palodhshëm pas të vërtetës dhe
të dijes. As'habët e Muhamme-



dit a.s. e shfrytëzonin çdo rast
në shoqëri me Muhammedin
a.s. të mësojnë, të jenë nxënësit
e Muhammedit a.s., çdo çast në
këtë botë ta kalojnë në shoqëri
me mësuesin më të madh, që
sa më shumë të mësojnë nga
ai dhe që fjalën e tij ta memo-
rizojnë përgjithmonë dhe këtë
mësim t'ua përcjellin nxënësve
të tyre si emanetin më të madh
të dhuruar. Më vonë edhe Ebu
Bekri, Omeri, Osmani, Aliu,
Ebu Hurejre, Abdullah ibn
Abbasi, Abdullah ibn Mesudi,
Enes ibn Maliku dhe as'habë
të tjerë u bënë mësues nga të
cilët tabiinët nuk janë ndarë,
kanë mësuar për fenë dhe për
mënyrën islame të jetës deri në
hollësitë më të mëdha. Nëse në
këtë mënyrë e kundrojmë rolin
e mësuesve të parë në historisë
islame, atëherë nuk e kemi të
vështirë ta kuptojmë hadithin
e Muhammedit a.s.: "Ulemaja
(dijetarët) janë trashëgimtarë të

pejgamberëve të Allahut."

BOTA KA NEVOJË PËR DIJE TË GJALLË E JO PËR LIBRA TË PAJETË

Mirëpo, sot kemi pak më-
sues të gjallë të cilët respek-
tin e kanë fituar me punë dhe
vepra të mira, por edhe më
pak nxënës (tul-lab), gjurmues
të palodhshëm për të vërtet-
tën dhe shoqërimin me ata të
cilët mund t'i udhëzojnë por
edhe mësojnë në diç të gjallë.
Sot kemi pak mësues të cilët e
mbajnë katedrën jetësore, por
kemi mjaft të tillë me katedra
profesionale.

Sa herë të kthehesh te ule-
maja, do të sheh këtë pasqy-
rë: njëri flet e të tjerët dëgjojnë
dhe mësojnë; dhe ... kanë çka
të mësojnë dhe ka çka të më-
sohet sa herë të shkosh.

Në anën tjetër, komerciali-



në shtëpinë e veta, ku nxënësit rreth tij mësojnë për Islamin, për jetën, për ekonominë dhe bujqësinë, të cilët pinë kafe dhe hanë syfyre dhe iftare, e të cilat ushqime i ka gatuar zonja e alimit. Ku është tretur ulemaja e vjetër, e cila mbase ka ditur më pak se alimët e sotshëm, por atë që e ka ditur sipas saj ka vepruar dhe kurrë nuk ka hequr dorë. Kurse atë që nuk e kanë ditur, me ndihmën e Allahut, me veprat e tyre të mira e kanë kompensuar. Do të ishte i mirëseardhur një alim i vjetër, të na mësojë se si bëhet sakrifikimi për fe dhe si bëhet mësimi i të tjerëve.

RAPORTI (JO) KOMUNIKUES “SA MË LARG AQ MË MIRË”

zimi tmerrues i veprimtarisë botuese islame ka sjellë deri aty që të botohet çdo gjë dhe gjithfarë titujsh. Ky trend ka shkuar deri aty që librat i kanë zëvendësuar mësuesit e gjallë. Vërtetë librat *e vdekura* mund të na ofrojnë informacione, por gjallërinë mahnitëse të fesë dhe udhëzimin njerëzor, mund ta ndiejmë dhe shohim vetëm në praninë e atyre që e kanë këtë gjallëri. Prandaj, ashtu sikur që sot ulemaja e gjallë është zëvendësuar me libra të vdekura, dhe atë gjerësisht të shtrira, të shkruara apo në formë elektronike, nga kushdo të shkruara dhe të shtypura, libra për Islamin dhe dispozitat e tij, shkronja të vdekura në letër, ashtu edhe feja na është bërë njësoj e pajetë, që të mos themi fe e vdekur. Në nënqiellin tonë shqiptar por edhe regjional e më gjerë kurrë nuk ka pasur më shumë alima të gjallë por

kurrë më pak alima-mësues dhe taliba-nxënës. Nxënës të cilët për shkak të mësuesit, alimit të tyre, edhe të zbathur edhe të zhveshur kanë ecur në mënyrë që të jenë me atë i cili do t'i mësojë mirë. Ata nxënës të cilët kur mësuesi i tyre ndërron jetë, ndiejnë dhembje më të fuqishme në bark se sa kur babai i tyre ndërron jetë. Sot nuk ka respektivisht sot janë raritet mësuesit të cilët me nxënësit e tyre sillen sikur me fëmijët në shtëpinë e tyre. Raftet po na pëlçasin nga pesha e librave me tituj të ndryshëm. Raftet janë përplot libra, dije ka pak, kurse vepra të mira më së paku. Më së paku ka vepra të mira të cilat nuk janë kontaminuar me ndonjë kalkulim të kësaj bote qoftë ajo mëditja, shpenzimet e rrugës apo rrezikimi i autoritetit. Nuk ka më mësues të mëdhenjë të cilët organizojnë tubimin e nxënësve

Të vjetrit mësuajnë se si t'i gjejnë imamët e rinjë, kurse këtë e dinë më së miri të rinjtë, duke i provuar metodat e tyre të edukimit dhe të udhëheqjes në jetën e tyre. Mësuesit e vjetër i zbuluan nxënësit e ardhshëm dhe i përgatitën për sfidat e ardhshme. Ata gjatë ceremonisë së mevludit apo të tubimeve të ngjashme, kanë ditur t'ua japin fjalën imamëve të rinjë, t'ua mundësojnë të mbajnë ligjëratat, pa kurrfarë xhelozie dhe duke shprehur kënaqësi ndaj ligjëratave të tyre para opinionit.

Ulemaja zyrtare sot nuk organizon kurrfarë tubimi madje as për nxënësit e saj të zgjedhur, kurse aty ku ekzistojnë këto organizime, ata bëhen objekt përfolesh. Mësimi institucional i Islamit dhe veprimtaria botuese islame e zëvendësoi mësimin e gjallë që deri atëherë zhvillohej ndërmjet

mësuesit dhe nxënësit.

Edhe në rrafshin institucional shpesh kemi dëshirë të themi se medreseja është vendi i fundit ku edukohet dhe arsimohet, kundrejt shkollave të tjera, të cilat, përgjatë vendit, vetëm arsimojnë. Por, nxënësit tonë, pak nga pak, zënë në thua, dhe mbështeten te profesorë të fakulteteve të tjera, nga të cilët përvetësohen (nxënësit tonë) dhe nën ambrellën e tyre e përfundojnë atë që ne nuk kemi arritur ta përfundojmë. Nuk kalon shumë kohë dhe këto shkolla të tjera me nxënësit tonë na sulmojnë. Kjo nuk ndodh vetëm me institucionet arsimore laike por edhe me ato muslimane. Nxënësi ynë vetëm për disa muaj të kaluar nëpër vende arabe-muslimane, përvetëson mënyrën e tyre të të menduarit, mënyrën e tyre të të vepruarit dhe atë që ne nuk e kemi arritur për njëzet vite të arsimimit dhe edukimit të fëmijëve tanë, atë e bëjnë të tjerët vetëm për disa muaj. Nxënësit tonë të dikurshëm bëhen kundërshtarët tanë më të rreptë, armiqtë tanë më të përbetuar, anatemuesit tanë më të qartë.

Mendojmë se arsyeja për këtë gjendje është komplekse, por një faktor me rëndësi të dorës së parë është gjendja që zotëron në institucionet tona politikëbërëse, edukatëbërëse dhe arsimbërëse. Në vend që ulemaja e shkollave tona t'i tubojë nxënësit dhe studentët tonë dhe t'i përgatisë ata për alima të nesërm, të cilët do të jenë të gatshëm t'u përgjigjet sfidave të kohës moderne, këtë punë e bëjnë profesorët e institucioneve të tjera, të filozofisë në Perë-

ndim apo të 'besimit' puritan në Lindje. Ata i tubojnë bijtë tanë, i aftësojnë sipas mënyrës së tyre dhe i përdorin për të na sulmuar. E dhembshme është të pranosh goditje nga nxënësit tu, ta vrasim traditën tonë fetare me bijtë tanë në emër të synimeve jo të sinqerta dhe trilleve të lodhshme.

Përse ndodh kjo?! Përse ulemaja aktuale e ditëve tona shtiret kaq profesionale dhe njëkohësisht kaq e largët nga nxënësit e vet? Mos edhe imamët që janë aktualisht dhe që do të vijnë, të mësuar nga ulemaja, do të bëhen skajërisht profesionalistë dhe skajërisht të larguar nga xhematlinjtë? Përse sllogani "sa më larg aq më mirë" po shndërrohet në parim?! Mos vallë ndjekja dhe përfundimi i studimeve nëpërmjet internetit, postës apo mënyrave të tjera komunikuese po i përgjigjet shumicës sonë?! Raporti i mësuesit kundrejt nxënësit që sikur vlerësohej si "baba" i dytë paraqet përqeshje si te nxënësit ashtu edhe te mësuesit e tjerë. Mënyra përëndimore e të menduarit, e të ndijurit, e të përjetuarit ka hyrë në palcën e shumicës nga ne. Më nuk bëhet dallim ndërmjet asaj të vjetrës por që i themi se është "e jona" dhe asaj moderne por që i themi se është "e huaja".

Modernja thotë se s'ka të keqe nëse flejmë në krahë të majtë, nëse urinojmë në këmbë, nëse hamë me dorë të majtë, nëse ne meshkujt veshim mëndafsh apo vëmë ndonjë unazë e gjerdan floriri, nëse femra muslimane nuk vë shami mbi kokën e saj, e të tjera e të tjera! Vërtetë



të gjitha këto që i përmendem nuk janë të këqijat më të rënda?!? Ok, pajtohemi me këtë konstatim të perëndimorëve, por nëse nuk ka asgjë të keqe në tërë këtë, atëherë përse modernistët këmbëngulin pikërisht në këtë ndryshim të pavlefshëm. Meqë janë pa rëndësi, përse e djathta nuk ngelet e djathtë, sepse është e djathtë! Përse nuk vendoset kufiri deri ku mund të shkohet në këto ndryshime? Nëse hiqet kufiri në këto çështjet e theksuara më herët, çka do të jetë vijuese: mos vallë do të jenë edhe pesë shartet e islamit, edhe gjashtë shartet e imanit, edhe guslli edhe shumë të tjera.

Mendoj se mësuesit e mëdhenjë duhet të jenë më afër nxënësve të tyre, mendoj se nxënësit duhet të afrohen më tepër rreth mësuesve të tyre, mendoj se e djathta duhet të mbetet e djathtë, sepse nuk e kemi bërë ne të djathtë të dhjathtë, por ajo vetvetiu është e djathtë dhe duhet të mbetet e djathtë.

Letërsia dhe Artet në Islam

Islami solli në ekzistencë një qytetërim, në të cilin artet gjithmonë kanë patur dhe vazhdojnë të kenë - në atë masë sa ç'është i gjallë ai qytetërim - një vend me rëndësi qendrore. Mund të thuhet se perspektiva islame mbështetet mbi përmasën e bukurisë në jetë dhe e lidh bukurinë e mirësinë me vetë natyrën e Allahut, siç pohohet në hadithin e mirënjohur: "Allahu është i bukur dhe e do bukurinë" (Allahu xhemilun juhıbbu'l-xhemal). Theksimi i sjelljes së hijshme dhe pastërtisë në jetën fetare e të përditshme si dhe urdhëresat e drejtpërdrejta në Kuran për ta çmuar bukurinë e krijimit dhe e të gjitha objekteve të krijuara nga Allahu pasqyrojnë interesimin qendror të Islamit për bukurinë. Duke shikuar krijimet e qytetërimit islam, që nga arkitektura dhe planifikimi i qytetit deri te poezia dhe forma të tjera të letërsisë vërehet domethënia

e artit - të kuptuar tradicionalisht - në universin islam. Kryeveprat e mëdha të artit islam, si xhamitë e mëdha të Kordovës në Spanjë, Kajravanit në Tunizi dhe Ibn Tulunit në Kajro ose më në lindje ato të Stambollit, Isfahanit e Samarkandit përfaqësojnë drejtpërsëdrejti jo vetëm shpirtin e shpalljes islame, por vetë thelbin e atij shpirti dhe në njëfarë kuptimi sigurojnë përgjigjen më të drejtpërdrejtë e të dallueshme ndaj pyetjes "Çfarë është Islami?". Në harmoninë, qartësinë, kthjelltësinë dhe paqen e tyre ato kristalizojnë disa prej aspekteve më të rëndësishme të mesazhit islam.

Arti islam ka qenë i aftë të sigurojë ndër shekuj një mjedis, në të cilin muslimanët kanë mundur të jetojnë e të funksionojnë në gjendjen e përkujtimit të Allahut dhe me vizionin e soditjen e bukurisë, e cila në fund mund të vijë vetëm prej

Allahut, që është i Bukuri (el-Xhemil) në kuptimin absolut e përfundimtar. Arti islam lidhet drejtpërsëdrejti si me formën, ashtu dhe me shpirtin e Kuranit dhe shpalljen islame. Ky art synon të pasqyrojë Unitetin Hyjnor, ndaj edhe shmangia nga ana e tij e çdolloj forme përfaqësuese të Hyjnores. Ai thekson brishtësinë e botës dhe përhershmërinë e çfarë shtrihet përtej saj. Ai kërkon ta lidhë artin me veprimtaritë e përditshme të njeriut dhe s'e ndan atë nga jeta. Në të vërtetë fjalët më të përdorura për artin në arabisht si *sina'ah* dhe *fann* nuk nënkuptojnë vetëm artin në sensin e sotëm perëndimor të termit, por gjithashtu punimin dhe krijimin e çdo gjëje me korrektesë e bukur. Për më tepër, Islami e thekson gjithmonë marrëdhënien ndërmjet artit dhe diturisë siç është pohuar tradicionalisht në botën islame nga shumë prej mjeshtrëve të mëdhenj të zana-

teve e artistëve, që kanë theksuar pareshtur se arti vjen nga martesë e fenn-it dhe hikme-s apo teknikës dhe urtisë.

Forma e jashtme e Kur'anit, bukuria dhe kuptimi i tij i brendshëm vijnë nga Allahu. Po kështu arti islam përfaqëson një mesazh, që ndodhet në zemër të shpalljes islame në forma të cilat gjithashtu pasqyrojnë drejtpërdrejtë prejardhjen shpirtërore e qiellore të Islamit dhe të cilat shpien tek Allahu. Si shpirti ashtu dhe format e artit islam frymëzohen nga dhe lidhen me shpalljen islame. Një studim tërësor i Kuranit, i kuptimit të tij të brendshëm si dhe i ritmeve, tingujve, shkronjave, prozodisë dhe fuqisë hipnotizuese së tij mbi shpirtat e muslimanëve, të kombinuara me studimin thelbësor të jetës së Profetit dhe bukurinë e shpirtit të tij të pasqyruar në veprimet dhe thëniet e tij (Hadith) do të shpalosin se cilat janë burimet e brendshme dhe të përfundme të themeleve të artit islam. Islami, sigurisht, ka huazuar shumë teknika nga qytetërimet e ndryshme si ai persian dhe bizantin në fusha të tilla si arkitektura, thurja e tekstileve, punimet e tunxhit dhe bakrit e shumë lloje të tjera arti. Mirëpo ai e shndërroi materialin që huazoi nga qytetërimet e ndryshme në dritën e shpalljes kuranore, duke krijuar forma shumë të dallueshme artistike, të cilat mund të shihen në viset që shtrihen nga Lindja në Perëndim.

Megjithëse ekzistojnë ndryshime lokale ndërmjet shkollave të larmishme të artit, që u përkasin rajoneve të ndryshme të botës islame, nga të cilët arti

persian përfaqëson mbase më prodhimtarin e më të gjerin, të gjitha llojet dhe shkollat e larmishme brenda qytetërimit islam ndajnë së bashku disa parime bazë. Ky art karakterizohet nga përdorimi i vazhdueshëm i arabeskës, formave gjeometrike dhe kaligrafisë, si simboli i pranisë së kudondodhur të Fjalës Hyjnore. Ai thekson atë që quhet "abstragim", i cili në të vërtetë do të thotë hapje në botën e kuptueshme dhe stilizimin e përsëritjen e formave, të cilat në njëfarë kuptimi e çojnë njeriun drejt soditjes së të Pafundmit në format e fundme. Të gjitha këto elemente shihen në artin islam, si në atë të Andaluzisë, Egjiptit, Persisë apo gjetkë. Sigurisht, çdonjëri prej grupeve të mëdha etnike të botës islame ka krijuar një art që është dallueshmërisht i tij, si ai persian, turk, egjiptian, afrikanoverior dhe andaluzian, indomusliman, indonezian, malezian etj., por uniteti i Islamit pasqyrohet përgjatë të gjitha këtyre traditave të larmishme e të pasura artistike.

LETËRSIA

Ndër artet e Islamit, këndimi i Kuranit është më i rëndësishmi dhe më qendrori. Ai është arti i shenjtë suprem i Islamit. Arti i këndimit të Kuranit sigurisht kombinohet në shumë kontekste me artin e shkrimit të Fjalës së Shenjtë dhe gjithashtu me recitimin e ndodhive e historive, që gjenden në aq shumë sure të Tekstit të Shenjtë. Këtu qendron arsyeja e pozitës së epërme që zë letërsia brenda botës kulturore të Islamit. Ndikimi i Kuranit mbi shpirtin e muslimanëve ishte aq i madh saqë mjedisi kulturor islam iu kthye



botës së letërsisë si formë qendrore e të shprehurit artistik, kudo që u përhap Islami dhe u ndje ndikimi i Kuranit.

Natyrisht gjuha dhe letërsia arabe morën të parat vulën e shpalljes kuranore, duke qenë se shpallja e kishte shndërruar vetë arabishten, duke e bërë mjetin e përshtatshëm për shprehjen e Fjalës së Allahut. Arabët kishin krijuar që më parë vepra madhore letrare në trajtën e poezisë përpara periudhës islame, në epokën e injorancës (el-xhahilijeh), por ishte ndikimi i Kuranit ai që e shndërroi këtë letërsi në letërsi islame.

Gjatë periudhës së hershme umejjade u shfaqën gjithashtu një sërë poetësh të rëndësishëm që shkruanin në arabisht, të cilët filluan të pasqyronin gjithnjë e më tepër etosin e Islamit në poemat e tyre. Poetë të tillë si Farazdaku dhe më vonë Hallaxhi shkruajtën poezi qartësisht islame e jo vetëm arabe. Po kështu në prozë, me shfaq-



edhe shumë njerëz në botën turke, indiane e madje kineze, fare larg Persisë. Persishtja u zhvillua drejtpërsëdrejti nën ndikimin e Kuranit, nga bashkimi ndërmjet gjuhëve të mëparshme iraniane të periudhës sasanide dhe fjalorit të arabishtes kuranore. Poetët e hershëm persianë imituan poetët arabë, gjersa poezia rudakie në persisht u mëvetësua. Ndërkohë, disa prej persianëve si Hallaxhi shkruanin në arabisht dhe u bënë poetë të shquar të kësaj gjuhe.

Vetë persishtja filloi të zhvillohej me shpejtësi pas shekullit të katërt islam me punime epike nga burra të tillë si Ferdusi, Shahname-ja e të cilit u bë eposi kombëtar i Persisë dhe poezinë fetare e mistike të lidhur me emrat e Sana'iut, Attarit dhe Rumiut. Këta njerëz shkruan disa nga poemat të dashuruara më universalisht në cilëndo gjuhë të botës. Nuk është e rastësishme që Rumi, ndikimi i të cilit është i pamat anëmbanë Azisë dhe jashtë vetë Persisë, veçanërisht ndër turqit e myslimanët indianë, është quajtur nga shumë njerëz poeti më i madh mistik që ka jetuar ndonjëherë. Persishtja vazhdoi të prodhonte poetë madhështorë edhe pas Rumiut, që jetoi rreth kohës së pushtimit mongol. Kryesorët ndër ta janë Sa'diu dhe Hafizi, i pari kryesisht një moralist dhe i dyti poeti më i madh i gjuhës perse, memorizues i Kuranit dhe autoritet i madh i Sheriatit, i cili është gjithashtu poeti suprem i dashurisë dhe i botës shpirtërore. Këta poetë i mundësuan persishtes të arrinte kulmin e përsosjes së saj letrare dhe të

jen e shkrimtarëve si Xhahidhi, letërsia arabe fitoi një përmasë shumë të dallueshme islame. Edhe në tregime të thjeshta si Njëmijë e Një Netë, të cilat i përkasin erës së vonë 'abbaside mund të vërehen shumë aspekte të mësimave të Islamit dhe jetës së shoqërisë islame, të pasqyruara nga letërsia.

Arabishtja është, sigurisht, shumë e pasur në traditën e saj letrare. Në arabisht ekzistojnë të gjitha llojet e punimeve me vlerë të madhe poetike e letrare që nga kaside-t e Buhturiut dhe poezia morale e didaktike e Mutenebbiut deri te poemat mistike të Ibn ul-Faridit dhe Ibn 'Arabiut; që nga esetë e Ebu Hajjan Tevhidiut deri te veprat historike e filozofike me vlerë të madhe si Hajj ibn Jakdhan ("Biri Gjallues i Vigjëluesit") i Ibn Tufejlit, që kanë vazhduar të shfaqen ndër kohëra. Mirë-

po, siç ndodh me të gjitha kombet, jo e tërë letërsia e prodhuar nga arabët kishte karakter të dallueshëm islam, por shumica dërrmuese e veprave në arabisht pasqyrojnë drejtpërsëdrejti etosin e Islamit. Kjo vlen sidomos për veprat e mëdha letrare, të cilat kanë qenë popullore ndër shekuj, si Burdeh ("Kënga e Mantelit") e Busiriut, në lavdërim të Profetit. Një veprë e tillë përbën një shembull të qartë të një arti letrar islam të një rendi të lartë, i cili pasqyron si formën ashtu dhe shpirtin e Kur'anit dhe Hadithit.

Efekti i ndikimit të Kuranit mbi letërsinë arabe shihet edhe në gjuhët e tjera islame. Pas arabishtes, gjuha më e rëndësishme e letërsisë në Islam është persishtja, e cila - sikurse arabishtja - u bë një gjuhë universale, në atë që nuk flitej e lexohej vetëm nga persianët por

vepronte e të ndikonte mbi letërsinë dhe poezinë e shumë gjuhëve të tjera.

Letërsia turke që ndër ato që përjetuan ndikim të thellë si rezultat i kontaktit me persishten. Për shekuj me radhë në botën osmane, figurat e mëdha letrare dinin persisht dhe ç'është e vërteta disa prej të hershmëve shkruanin poezi klasike turke në formën e modeleve klasike persiane. Megjithatë, më vonë poetët turq iu kthyen gjithnjë e më tepër gjuhës së thjeshtë të popullit dhe u krijua një traditë e pasur letrare nga figura të tilla si Ahmed Jesevi dhe Junus Emre, i cili është mbase më i madhi i të gjithë poetëve turq, një figurë poezia e të cilit mbetet shumë popullore edhe sot e kësaj dite. Shkrimtarët turq imituan në njëfarë mase edhe modele letrare arabe, por edhe në këto raste ato ishin kryesisht modele tashmë të pranuar në letërsinë persiane.

Mund të thuhet shumëçka mbi gjuhët e tjera të popujve islamë, por duhet të jemi të përmbledhur. Në nënkontinentin indian, gjuhë si sindishtja, kashmirishtja, guxharatishtja dhe bengalishtja e pasqyrojnë të gjitha në thellësi shpirtin e Islamit dhe kanë zhvilluar letërsi të mirështjelluara me karakter islam, zakonisht të ndikuara thellësisht nga persishtja dhe sigurisht nga prania e drejtpërdrejtë gjalluese e Kuranit. Po ashtu në Indi, që nga shekulli i tetë islam e më tej është zhvilluar gjuha urdishte, e cila u formua nga një kombinim i sanskritishtes dhe persishtes me shtimin e një sërë fjalësh turke dhe e cila u zhvillua gjithnjë e më tepër si gju-


hë islame, deri në shekujt XIII e XIV islamë, kur u mëvetësua si gjuhë madhore islame, në të cilën filluan të shkruheshin një mori veprash letrare si në prozë, ashtu dhe poezi. Urdishtja ishte destinuar të bëhej gjuha kryesore e kulturës myslimane në Indi porsa u ndalua persishtja nga sundimtarët britanikë dhe pikërisht kjo gjuhë flitet dhe kuptohet sot nga më tepër myslimanë se cilado gjuhë tjetër, sigurisht me përjashtim të arabishtes së Kuranit.

Duke iu kthyer Afrikës, vërehet e njëjta dukuri. Në Afrikë, me përhapjen e Islamit, gjuhët vendase filluan të pasqyrojnë shpirtin dhe format e letërsisë arabe dhe jo të asaj persiane. Në këtë kontinent, ndikimi i persishtes ishte i vogël ndërsa i arabishtes qendror. Që nga Afrika Perëndimore ku gjuhët berbere, hauze, fulande dhe gjuhë të tjera madhore të saj zhvilluan letërsi tejet të gjera islame deri në lindje, ku mbizotëruan gjuhë të tilla si somalishtja, harrarishtja e sigurisht suahilishtja, vërehet ngritja ndër shekuj e një tradite madhore letrare në Afrikën e zezë myslimane. Disa prej këtyre letërsive mbetën gojore dhe u shkruan mjaft vonë, shpesh në alfabet latin, ndërsa të tjera përvetësuan alfabetin arab dhe arritën të zhvillonin një letërsi të shkruar mjaft të njohur. Por, qoftë gojore apo e shkruar, letërsia e popujve islamë të Afrikës përfaqëson një tjetër degë madhore të letërsisë islame duke përdorur sërish shpirtin, formën dhe përmbajtjen e Kuranit dhe modeleve letrare të arabishtes, por duke pasqyruar njëkohësisht jetën vendase të myslimanëve të



kontinentit afrikan.

Sa u përket viseve islame në Azinë Lindore, sërish shohim tek malezianët ndikimin e drejtpërdrejtë të veprave të letërsisë arabe dhe perse nga shekulli i shtatë islam deri tek i dhjetti, çka rezultoi në një sërë figurash vendase si Hamza Fansuriu, Sumatranu, Raniriu e të tjerë, që filluan të shkruanin vepra letrare në malezjisht të bazuara shpesh mbi ndodhitë e jetës së Profetit ose letërsinë sufiste, nga figura të tilla si Xhamiu dhe para tij Gazzaliu, ndërkohë që edhe shumë prej veprave madhore klasike të letërsisë sufiste nga arabishtja e persishtja u përkthyen në malezjisht. Madje edhe ndër myslimanët kinezë lindi një traditë e rëndësishme letrare islame, me referenca të drejtpërdrejta ndaj mësimëve kuranore dhe historisë së hershme islame, por e cila u zhvillua në mënyrë shumë të veçantë në mjedisin dhe gjuhën kineze, duke vënë në përdorim gjithashtu një mori figurash e trajtash të traditës letrare kine-



ze. Ka shumë forma dhe shko-lla të tjera të letërsisë islame në degët e ndryshme të gjuhëve turke, që i përkasin Azisë Qendrore ose gjuhëve të tjera afrikane, të cilat nuk mund t'i përmendim këtu. Ajo që ka rëndësi të kuptohet është se në jetën e vet katërbëdhjetë shekullore në këtë botë, Islami ka mundur të krijojë një sërë letërsisë madhore si në prozë, ashtu dhe në poezi, të cilat pasqyrojnë etosin, shpirtin dhe përmbajtjen e Kur'anit e Hadithit.

Në qytetërimin islam vihet theks i posaçëm mbi poezinë, që zë një vend të lartësuar ndër popujt islamë jo vetëm arabët e persianët, por edhe popuj të viseve të largëta që nga Afrika në Azinë Lindore. Megjithatë, disa forma letrare si romani, të cilat mbizotërojnë në Perëndim sot nuk janë zhvilluar kurrë nga myslimanët. Arsyeja është se forma të tilla të letërsisë, sidomos në formën e zhvilluar në shekujt XIX e XX, janë në të vërtetë kryesisht përpjekje për të krijuar një botë subjektive dhe

fiktive, ku lexuesi udhëton në harrimin e realitetit të Allahut, një botë që Islami e ka kundërshtuar gjithmonë në parim.

Sa për teatrin dhe dramaturgjinë, në sajë të mungesës së theksimit në perspektivën islame të dramës - kuptuar në sensin burimor grek - nga myslimanët nuk i është kushtuar fort vëmendje dramës greke dhe shumë pak është shkruar që t'i ketë përkatur vërtetësisht teatrit e dramaturgjisë siç kuptohen në Perëndim, ndonëse zhanret letrare islame zakonisht s'janë të zbrazura nga modele apo shembuj, që e kanë njëfarë ngjashmërie si me dramën, ashtu edhe romanet. Në rastin e dramaturgjisë, vijnë ndërmend krijimet prekëse të lidhura me tragjedinë e Qerbelasë. Sa për romanin, mund të përmenden romanet filozofike, sidomos Hajj ibn Jakdhan nga filozofi e mjeku i famshëm andaluzian Ibn Tufejl, veprën e të cilit shumë njerëz e konsiderojnë zanafillën e romanit të parë evropian.

Megjithatë, në përgjithësi vendi i nderit në letërsinë islame i takon poezisë epike dhe fetare nga njëra anë dhe rrëfimeve nga ana tjetër. Të gjitha këto lloje veprash ishin mbarsur me vlerat e përmbajtura në Kuran e Hadith dhe plotësuan drejtpërsëdrejti tekstet fetare në jetën e muslimanit tradicional, ku një vepër e tillë letrare ka dhënë e vazhdon të japë mësim të thella morale të rrokshme, të cilat muslimani duhet t'i nxjerrë në udhëtimin e tij mbi dhë. Është e mahnitshme se në ç'masë përbën në të vërtetë letërsia islame një zgjerim të disa thënieve të Profetit ose komente mbi ngjarje të ndryshme të Kur'anit, në mënyrë të atillë që e tërë letërsia e popullit islam u mbars nga vlerat dhe mësimet e fesë.

NDIKIMI I ARTIT ISLAM

Tradita artistike e Islamit ka lënë ndikim të madh jo vetëm brenda botës islame, por edhe mbi qytetërimet që e rrethojnë. Në Lindje, ndërkohë që arti islam u ndikua deri në njëfarë

mase nga kinezi, siç mund të shihet në pikturat persiane të miniaturës, ai gjithashtu ndikoi shumë lloje të artit kinez, që nga vazot deri te qilimat. Po kështu brenda Indisë, pati një ndërthurje në vende të caktuara si Fatehpur Sikri ndërmjet artit islam dhe atij hindu, ndërkohë që vetë arti islam krijoi disa prej kryeveprave të tija më të mëdha në tokën indiane, si Taxh Mahalli.

Sa i përket perëndimit, aspektet e ndryshme të artit islam, nga poezia e muzika tek arkitektura lanë gjurmë të thella në shumë tipare të artit mesjetar evropian, me shtrirje që nga harqet në arkitekturë te ndriçimi i dorëshkrimeve latine dhe hebreje të shekujve XIII e XIV. Sa i përket specifikisht artit çifut, jo vetëm në Spanjë por edhe në vise të tilla si Marok, Jemen, Persi dhe Egjipt, ai mbeti i lidhur ngushtë me artin islam. Harqet dhe zbukurimet e brendshme të sinagogës së Kordovës dhe Toledos pasqyrojnë edhe sot e kësaj dite marrëdhënien e ngushtë ndërmjet artit dekorativ dhe ornamental të sinagogës dhe atij të xhamisë.

Për më tepër hedhja dritë mbi dorëshkrimet hebreje, qoftë nga Persia apo Spanja pasqyrojnë afrinë e botës artistike në të cilën jetonin çifutët me atë të myslimanëve, me të cilët ata bashkëpunonin shpesh nga afër gjatë shekujve, në fusha të ndryshme artistike, përfshi muzikën.

DY FJALË PËR MUZIKËN

Së fundi, para mbylljes së këtij diskutimi, duhet thënë

diçka edhe për muzikën. Ka 'ulema' që e kanë konsideruar muzikën të ndaluar (haram), ndërsa të tjerë e kanë parë të lejuar për ata, të cilëve ajo nuk ua ndez pasionet. Sidoqoftë, kësaj çështjeje nuk i është dhënë kurrë përgjigje kategorike nga juristët në historinë islame, ndërkohë që muzika u zhvillua gjerësisht në viset e ndryshme të Islamit, shumë prej saj në mënyrë të kulluar fetare e shpirtërore. Ekziston sigurisht muzika ushtarake dhe ajo e kënduar nga fshatarët në periudhë korrjesh etj, me natyrë më tepër folklorike. Por ekzistojnë gjithashtu traditat klasike të muzikës, nga të cilat më madhoret në qytetërimin islam janë arabja, persiana, turkja dhe ajo myslimane e Indisë së Veriut, që është bërë e njohur si muzikë indiane por shumica e ekzekutuesve të së cilës deri sot e kësaj dite kanë emra islamë. Këto shkolla të muzikës e pasqyrojnë në masë të madhe aspektin brendësues të këtij arti në botën islame. Ato nuk janë arte që përdoren për qëllime shoqërore, si muzika e kërcimit që dëgjohet në Perëndim. Përkundrazi, ato zakonisht lidhen me poezinë mistike dhe gjendjet soditëse fetare e shpirtërore. Kjo muzikë u zhvillua ndër shekuj kryesisht nga mistikët islamë, prej sufive të tillë si Xhelaledin Rumi dhe Amir Hosrovi. Kësisoj, muzika tradicionale u lidh ngushtë me letërsinë, sidomos poezinë, duke krijuar një mjet të përkryer për madhërimin e Allahut dhe një ndihmës të fuqishëm për kujtimin e Tij.

Sigurisht, siç u përmend më parë, arti i epërm që ka të bëjë



me tingullin dhe i cili përbën "muzikën" supreme në Islam (megjithëse fjala muzikë nuk përdoret kurrë për të) është këndimi i Kuranit Fisnik. Këndimi i Kuranit është në një kuptim përvoja protomuzikore e shpirtit të myslimanit dhe burimi i etosit të shkollave klasike të muzikës që janë zhvilluar ndër shekuj, ashtu sikurse teksti i tij është burimi i letërsive së popujve islamë. Po kështu, Kurani i përmban në mënyrë të hollë parimet dhe përbën origjinën e shpirtit të arteve pamore të Islamit, qoftë kaligrafisë, e cila burimisht lidhej drejtpërsëdrejti me tekstin e Kuranit, apo arkitekturës, që krijon hapësira ku myslimani dëgjon përgjatë tërë jetës bukurinë qiellore të Fjalës së Allahut, e cila jehon nga mihrab-i nëpër hapësirat e xhamisë dhe nga minarja nëpër hapësirat e mjedisit urban islam.

Ndjekja e sunnetit, detyrë për çdo musliman



Pas ngritjes së profetit Isa a.s ne qiell, bota ishte në kaos. Kudo kishte idhujtari. Moralet dhe vlerat kishin humbur. Në një hadith profetik thuhet se kjo është periudha më e keqe dhe më e zezë në historinë e njerëzimit. Në rruzullin tokësor nuk gjendej asnjë musliman. Dhe Allahu azze ve xhel për këtë arsye dërgoi në tokë mëshirë, duke sjellë në jetë “krenarinë e njerëzimit”, profetin Muhammed a.s.

Qëllimi i ardhjes së tij ishte pastrimi I idhujtarisë nga rruzulli tokësor, ngritja e moraleve të larta dhe risjelljen e mesazhit se “nuk ka zot tjetër përveç AllahuT” I cili është Një dhe I Vetëm.

Gjatë gjithë jetës, si para profetësisë ashtu edhe gjatë profetësisë, ai u dallua për morale dhe cilësi të larta. Allahu xh.sh thotë në Kur`anin Famëllartë; “Me të vërtetë, ti (o Muhammed) ke morale të larta”.

Meqë shpalljet hyjnore të mëparshme ishin ndryshuar, Allahu xh.sh zbriti librin e fundit

hyjnor, Kur`anin Fisnik. Për 23 vjet me radhë Kur`ani I zbriti profetit Muhammed s.a.u.s nga meleku fisnik, Xhibrili a.s. Kjo shpallje e fundit hyjnore kishte nevojë për një shpjegim më preciz, pasi Kur`ani ishte libri I fundit hyjnor dhe nuk do kishte më libër tjetër hyjnor pas tij. Rolin e këtij shpjeguesi e bëri Sunneti, tradita e profetit Muhammed a.s, thënie dhe mësim që I kishte të inspiruara nga Allahu, siç e thotë Allahu në Kur`an;

“Ai nuk flet me hamendje. Ajo nuk është tjetër vetëm se shpallje që shpallet.” (suretu En-Nexhm; 3-4).

“Çkado që ju jep Pejgamberi merreni, e çka t`ju ndalojë, përmbaheni (largoheni) prej saj.”(suretul Hashr; 7).

Profeti e përfundoi misionin e tij, e shpalli të vërtetën nga Zoti I Tij dhe e ndau atë nga e kota, kështu që fundi I tij po vinte shumë shpejt!

Profeti përsa ishte gjallë, ishte shembulli ideal për çdo individ në çdo fushë të jetës.

Allahu subhanehu ëe teal thotë në Kur`anin Fisnik; "Pejgamberi I Allahut është shembull I mrekullueshëm, për atë që shpreson mëshirën e Allahut në botën tjetër." (suretu en-nisa; 59).

Profeti ndërroi jetë!!! çfarë do të ndodhte me muslimanët vallë?! A do ishin sërish të bashkuar si më parë?! Këto pyetje mund t'i bien kujtdo në mendje! Profeti ndërroi jetë, por ama, ai na la diçka me të cilën mund të gjykojmë dhe të jetojmë, e ato janë siç e thotë profeti Muhammed s.a.u.s edhe në një hadith; "Iu kam lënë pas Kur`anin dhe Sunnetin, andaj përmbahuni atyre."

Pra, muslimanët kishin dy pika referimi bazë; Kur`anin dhe Sunnetin.

Allahu e bëri profetin Muhammed s.a.u.s më të dashurin e Tij.

"Thuaj; nëse e doni Allahun, pasomëni, që Allahu do t'ju dojë dhe do t'ua falë mëkatet." (sure Ali Imran; 31).

Vëllau im! Allahu e nderoi "krenarinë e njerëzimit", Muhammedin a.s më shumë se çdo krijesë tjetër.

Po ti vallë, sa e do atë?! Kur fyhet personaliteti I tij, çfarë bën ti?!

Je I kënaqur me këtë gjë apo e kundërshton atë?!

Vëllau im! Rruga e profetit është rruga e vetme e drejtë, siç e thotë ai a.s në një hadith nga Buhariu ku Ebu Hurejra r.a transmeton se I dërguari I AllahuT s.a.u.s ka thënë; "Krejt ummeti im do të hyjë në Xhennet, përveç atij që nuk do." I thanë; "E kush nuk do, o I dërguari I AllahuT?"

Tha; "Kush ndjek rrugën time, ai do të hyjë në Xhennet, ndërsa kush nuk e ndjek atë, ai nuk do."

A e do Xhennetin ti, o vëllai im?! Po, vallë,

a po e ndjek këtë porosi të profetit tonë të dashur?!

A po I ndjek gjurmët e tij?! Le t'ia bëjë çdo-kush këto pyetje vetes.

Dije vëllau im dhe ti, motra ime se një nga rrugët themelore të Xhennetit është Sunneti. Nëqoftëse nuk e ndjek atë, ke probleme. I nderuar vëlla! Jemi në kohë El-Hamdulillah!

Le t'i kthehemi jetës dhe veprës së këtij kolosi botëror që ndonjë tjetër si ky, nuk ka parë ndonjëherë bota. Duaje atë dhe ndiq udhën e tij që të jesh prej të shpëtuarve, dhe padyshim që gjithçka është në dorë të AllahuT të Madhëruar. Respektoje profetin sepse njëkohësisht ke respektuar edhe Allahun, siç e thotë edhe Allahu në një ajet Kur`anon;

"Kush e respekton Pejgamberin, e ka respektuar edhe Allahun."

"Kush i bindet AllahuT dhe të dërguarit, me të ka fituar një fitore të madhe (Xhennetin)."



Vakëfnameja e Shejh Magribiut

Shpallja e reformave në një pjesë të mirë të tyre me frymë perëndimore me فرمانin e Gylhanes që shënonte edhe fillimin e periudhës së Tanzimatit në perandorinë osmane nuk e dobësoi autoritetin e institucioneve fetare, përkundrazi e forcoi më shumë pasi që këto institucione tani u inkorporuan brenda organizmit administrativ të perandorisë. Shejhulislami e forcoi pozitën e tij, ndërsa zyrat kryesore të meshihatit që ndodhej në Stamboll filluan të funksiononin totalisht si zyra shtetërore aq sa gjyqet fetare krijuan një linjë paralele me gjyqet civile, madje edhe ato ushtarake.


Në këtë drejtim u fuqizua edhe institucioni i vakëfit dhe u riorganizua në rang të lartë administrativ institucioni i menaxhimit dhe administrimit të vakëfeve. Prona vakëf për nga rëndësia zinte vend menjëherë pas pronës shtetërore, dhe krijonte epërsi edhe mbi pronën private, sepse në dallim nga kjo e fundit nuk mund të sekuestrohej nga shteti në asnjë mënyrë.


Elementi i huaj në tërësinë e tij paraqet një rëndësi për historinë e Shqipërisë, në mënyrë të veçantë për historinë e institucioneve të kultit dhe të kulturës së përgjithshme. Në herë të parë ai nënkupton vendosjen e një guri në koloritin e mozaikut shqiptar të mesjetës së vonë. Bashkësitë e huaja të besimeve të ndryshme, udhëheqësit apo figurat e ngritura që jetuan një kohë të gjatë në trojet shqiptare dhe duke filluar nga mesi i shek. XIX studiuesit e huaj, në përgjithësi perëndimor që vërshuan për tu njohur me kulturën e shqiptarëve duhet të kenë lënë burime të vyera për ndriçimin e jetës kulturore që u zhvillua në trevat shqiptare gjatë sundimit osman.

Personi që dëshironte të linte vakëf prona për

një objekt të kultit fetar, që mund të ishin xhami, mesxhide, teqe, medrese etj. ose për ndonjë shërbim bamirësie siç ishte për shembull vakëfet për mirëmbajtje rrugësh publike, shërbimesh ndaj nevojtarëve, mensave për të varfrit etj. me këtë rast përgatiste një akt zyrtar që quhej vakëfname. Një kopje e vakëfnameve regjistrohej fjalë për fjalë në regjistrat e gjykatësve (kadinjve).

Vakëfnameja që ne kemi në dorë është një kopje e viteve të fundit të sundimit osman, origjinali i së cilës nuk dihet se ku mund të jetë nëse i ka shpëtuar rrebeshit të kohës dhe nuk është zhdukur. Ajo u pat ruajtur nga ana e studiuesit të mirënjohur oriental dhe njërit nga





njohësit e pakët të osmanishtes gjatë sistemit monist në Shqipëri, Hamdi Bushati, i cili ia pat dhuruar këtë kopje bashkë me disa dokumente të tjera Arkivit të Shtetit.

Kjo vakfije u hartua dhe u shkrua në emër të sheh haxhi Ahmed efendi Magribit, me origjinë nga Maroku i Magribit i cili kishte dyzet vjet që jetonte në qytetin e Shkodrës, në lagjen Kara Hasan (Karahase), një nga dijetarët më të mëdhenj dhe të respektuar, i cili i ka kërkuar birin të tij të madh Mehmet Eminin të pranojë autorizimin që dëshiron t'i japë dhe i biri e ka pranuar këtë të drejtë autorizimi prandaj u paraqit përpara këtij gjyqi të ndritur të shariatit për të deklaruar në emër të të atit se ai dëshiron të regjistrojë këtë vakfije si më poshtë, shtëpia që ai posedon në lagjen ku jetonte e cila ishte e kufizuar në katër

anët e saj me shtëpitë e shejh Mehmedit, myezin Umerit, Umer Podgoricës dhe Hysen Misirliut, një shtëpi me më shumë se një kat dhe me katër dhoma që përfshinte edhe dy puse me ujë, një depo sane, një kopsht brenda të cilit kishte pemë me fruta dhe pa fruta, në të cilën gjatë hartimit të vakëfnamesë jetonte ende Shejh Magribiu si dhe një vresht që gjendet në fshatin Troshan që varej nga kazaja e Zadrimës, kufijtë e të cilit ishin të njohur nga të gjithë fqinjët dhe banorët e fshatit, si dhe një numër të caktuar dhe të ditur librash me vlerë që ishin pronë e tija. Të gjitha këto Shejh Magribiu dëshiroi ti ngrijë si pronësi pasi që donte ti dhuronte si vakëf me vlerë të saktë juridike kushtet e të cilit ai i caktoi si vijon. Të gjitha këto prona kopshte, shtëpi dhe librat do të ishin pronë e tija sa të ishte gjallë dhe kur të vdiste atëherë kur e ka caktuar Allahu i madhëruar, librat të cilët i kishte shkruar dhe i kishte zbuluar me dorën e tij do t'i dhuroheshin medresesë së Kara Mahmut Pashës (Bushatit) e cila ndodhej në qytetin e Shkodrës, në mënyrë që nxënësit e shkencave që janë të përgatitur dhe të mirinformuar me mësimet e fesë të mund ti merrnin dhe ti lexonin në mënyrë që të përfitonin prej tyre dhe të këndonin një Fatiha për shpirtin e tij pasi të kishin përfituar prej tyre dhe ti vendosin aty ku i kishin marrë, ndërsa librat që ishin shkruar me kaligrafinë e Magribit të shënohen (vulosen) me shenjën e vakëfit dhe nëpërmjet një njeriu të besueshëm dhe të sigurt të dërgoheshin në xhaminë e Zejtunës në Tunizi. Shtëpia do ti mbeste djemve të shejh Magribit Mehmed Eminin, Hasanit, Hysenit, Sulejmanit dhe Mahmudit, ndërsa kopshti i vreshtave të shitej dhe me paratë që do të merreshin nga shitja e tij të mbuloheshin nevojat imediate të banesës ku jetonin bijtë e shehut dhe të ardhurat e këtij vakfi të vazhdonin brez pas brezi në bijtë e tij dhe në bijtë e bijve të tij derisa këta të mos kenë pasardhës dhe kur të mos kishin të tillë atëherë ky vakëf do ti kalonte myteveliut të xhamisë së Karahases.

Data e hartimit të vakëfnames së Sheh Magribiut është Muharrem 1284 H /1868.

RËNIA E FLOKËVE, FAKTORËT QË NDIKOJNË NË DOBËSIMIN DHE RËNIEN E TYRE

Edhe pse flokët nuk kanë një rëndësi jetike në organizmin e njeriut, ato luajnë një rol të jashtëzakonshëm psikologjik. Megjithatë, të gjithëve na ka lindur pyetja: përse bien flokët?

Dhe sigurisht që përgjigjet kanë qenë të shumëllojshme, por si e shpjegojnë mjekët specialistë këtë fenomen. Sipas tyre, shkaqet e rënies së flokëve ndahen në dy lloje: me skar dhe pa skar. Shkaku më i shpeshtë i rënies së flokëve është alopecia androgenike, problem i cili është më i theksuar te meshkujt.

Gjithashtu, mendohet se një faktor tjetër i rënies së flokëve është trashëgimia. Një tjetër faktor që luan rol në rëniën e flokëve është alopecia areata që karakterizohet me rëniën e flokëve vende vende, e cila mendohet se shkaktohet nga një burim infeksioni tek ata persona të cilëve iu ka rënë rezistenca imunitare e trupit.

Ky lloj komplikacioni mund të shërohet vetë ose duke përdorur ilaçe me kortizon apo me kurë drite. Një tjetër komplikacion është ajo që quhet Telogen effluvium, si pasojë e së cilës flokët kalojnë prej një kohe të shkurtër nga periudha aktive në atë të shpërndarjes. Në këtë rast ka një rënie masive të flokëve dhe për rreth katër muaj flokët hollohen dhe rrallohen.

Kjo gjendje mund të shfaqet edhe në mënyrë fiziologjike pas lindjes dhe te të sapolindurit.

Rënia e flokëve sigurisht shkaktohet edhe gjatë kurimit të sëmundjeve të tjera, si për shembull: Sëmundjet e rënda infektive, disa ilaçe që përdoren për sëmundjen e epilepsisë, ndërhyrjet e rënda kirurgjikale, ilaçet e kemoterapisë (kancerit), disa hormone dhe metale të rënda.



Përveç këtyre faktorëve dhe komplikacioneve që përmendëm, ka edhe sëmundje të tjera që ndihmojnë në dobësimin dhe rëniën e flokëve. Në kurimin e këtyre rasteve, bza është largimi i shkakut.


Për shembull: nëse është ilaçi ai që po e shkakton rëniën e flokëve, ky i fundit të ndërpritet, por me kusht që ndërprerja e tij të mos shkaktojë më shumë dëm në trup sesa rënia e flokëve.

Në rastin e infeksionit që përmendëm më lart, telogen effluvium, pas kurimit të tij flokët dalin sërisht. Në rastin e rënies së flokëve me skar, dëmtimi i flokut është mjaft i rëndë edhe mundësia për të dalë përsëri nuk ekziston.

Kanceri i lëkurës, kura me rreze, djegiet e rënda me lëndë kimike apo termale, disa infeksione të rënda fungale apo tek disa sëmundje të rënda dermatologjike janë disa nga shkaktarët. Megjithatë, cilido që të jetë shkaktori i rënies së flokëve, personi që vuan nga ky problem mjafton të kontaktojë me mjekun dermatolog, pasi problemi mund të jetë shumë i thjeshtë poër t'u kuruar.

SËMUNDJA KORONARE, SI T'I DALLOJMË SIMPTOMAT PA SHKUAR NË INFARKT

Sëmundjet e zemrës janë përhapur frikshëm në vendin tonë, duke u kthyer në sëmundjen vras-tare numër një në vargun e sëmundjeve të tjera. Sipas mjekëve çdo ditë shënohet një numër rekord shtrimesh pranë këtij pavijoni me problem serioze të zemrës. Gjatë stinës së verës këto komplikacione bëhen më të rrezikshme dhe më të shpeshta, për arsye të ngritjes së temperaturave që ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në acarimin e problemeve koronare. Në lidhje me shumëllojshmërinë e sëmundjeve të zemrës, mjekët kardiologë shpjeguan se një nga sëmundjet më të shpeshta të zemrës që vihet re te personat që paraqiten pranë kardiologjisë, është sëmundja koronare e zemrës. Kjo sëmundje shkaktohet nga grumbullimi i substancave të yndyrshme brenda mureve të arteries së zemrës. Por çfarë është në të vërtetë sëmundja koronare e zemrës dhe cilat janë simptomat me të cilat shfaqet kjo sëmundje? Në lidhje me këtë, mjekët kardiologë shpjeguan se në këtë sëmundje, arteriet që ushqejnë zemrën me oksigjen dhe lëndë ushqyese bëhen më të ngushta prej arterosklerozës. Këto komplikacione kufizojnë furnizimin e zemrës me gjak dhe oksigjen dhe kjo ndodh sidomos gjatë sforcimit, kur zemrës i duhet të punojë më shumë. Për sa iu përket shenjave dhe simptomave të sëmundjes koronare, mjekët shpjeguan se shenja kryesore është angjina e shkaktuar nga reduktimi i sasisë së oksigjenit që arrin në muskul, si pasojë e pakësimit të fluksit të gjakut në organizëm. Sipas mjekëve kardiologë, angjina është një komplikacion që ka lidhje me ndjenjën e rëndesës, pickimit apo dhimbjes në mesin e krahavorit, që mund të përhapet ose mund të prekë edhe krahun e majtë, qafën, mjekrën, fytyrën, shpinën ose barkun. Gjatë problemeve që shkakton sëmundja koronare, në pjesën më të madhe të rasteve mjekët shpjegojnë se i sëmuri përjeton një sforcim. Kjo ndjejnë rëndese ndihet në rastet nëse i sëmuri vrapon për të kapur autobusin, ngjit shkallët, në të ftohtë apo pas një ngrënie të rëndë, si edhe në rastet kur i sëmuri ndjehet i stresuar. Sipas kardiologëve, këto shqetësime mund të ndalojnë nëse i sëmuri e ndalon sforcimin fizik dhe psikologjik, apo merr mjekimin e rekomanduar nga mjekët specialist. Ndërsa në “linjën fatale” të sëmundjeve të zemrës futen infarktët, të cilët përbëjnë edhe atë që quhet vrasësi numër një i shqiptarëve në listën e sëmundjeve më të përhapura në vendin tonë. Mjekët kardiologë



shpjeguan se infarkti më i rrezikshëm dhe fatkeqësisht më i shpeshtë është infarkti i miokardit. Sipas mjekëve specialistë, infarkti i miokardit është shenja e parë për disa njerëz që tregojnë se diçka nuk shkon siç duhet në zemrën e tyre. Këto shqetësime ndodhin zakonisht kur furnizimi me gjak për një pjesë të muskulit të zemrës ndërpritet totalisht. Shfaqja e këtyre llojve komplikacionesh ndodh në rastet kur ndonjë copë gjaku e mpiksuar ndalon pikërisht në zonën e arteries së zemrës së ngushtuar tashmë nga arteroskleroza. Mjekët shpjeguan se, në këto raste dhimbja është shumë e fortë dhe nuk ndalon nëse i sëmuri pushon ose merr medikamentet e zakonshme. Megjithatë, nganjëherë kjo dhimbje mund të shfaqet në forma më të lehta dhe të ngatërrohet me ndonjë çrregullim të tretjes apo dhimbjeve të stomakut. Por nuk mungojnë edhe rastet kur infarkti nuk ka fare dhimbje. Gjysma e vdekjeve në çdo vit kanë në bazë një shkak të lidhur me sistemin e qarkullimit të gjakut. Kështu, specialistët e Ministrisë së Shëndetësisë bëjnë të ditur se çdo vit në vendin tonë vdesin rreth 8 mijë persona nga sëmundjet e zemrës. Por ajo çka e bën situatën tragjike, është fakti se mjekët nuk u kushtojnë vëmendje faktorëve të riskut, kur pacienti paraqitet për vizitë. Të ndodhur përpara kësaj situatë, Instituti i Shëndetit Publik ka përgatitur një model të ri shërbimesh pranë mjekut të familjes, me qëllim kapjen e hershme të shkaqeve të mundshme të sëmundjeve kardiovaskulare dhe trajtimin në kohë të tyre. Për sa iu përket simptomave dhe shenjave të tjera të atakut të zemrës, mjekët shpjeguan se ato janë: vështirësia në frymëmarrje, djersitja, të përziera dhe të vjella, komplikacione të cilat nuk qetësohen kur pacienti është në gjendje pushimi. Mjekët bëjnë apel që, nëse njerëzit ndjejnë të tilla komplikacione në organizmin e tyre, ata duhet të drejtohen te mjeku specialist.

ASTRONOMI ZBULOHEN 32 PLANETE TE REJA

Një zbulim rekord. Në një konferencë të titulluar “Drejt tokave të tjera” protagonistët e projektit HARPS (High Accuracy Radial Velocity Planet Search) kanë deklaruar se kanë zbuluar plot 32 planete të reja ekstra solare, që sillen rreth yjeve të tjera të galaktikës tonë Rruga e Qumështit: Janë të gjithë më të mëdhenj se Toka, dhe asnjë i banueshëm. Projekti nisi 5 vjet më parë nën drejtimin e Michel Mayor të Osservatorit të Gjenezës dhe në të janë përfshirë nja 20 astronaut evropianë.

Çelësi i suksesit ishte një instrument i instaluar në teleskopin 3.6 metra të ESO-s (European Southern Observatory) i cili vepron në La Silla në Kili. Bëhet fjalë për një spektroskop me një rezolucion ekstremisht preciz me të cilën shkencëtarët kanë matur lëvizjet e vogla (para dhe pas) të shkaktuara nga rrotullimi i planetëve, duke arritur të marrin një variacion të shpejtësisë deri në 3.5 km në orë.

Me HARPS studiuesit kanë zbuluar prezencën e 75 planeteve në një hark kohor prej 5 vitesh në 30 sisteme planetare të ndryshme, në rreth 400 planete ekstrasolare të zbuluara deri tani nga të gjithë studiuesit e astronomisë. Identikiti i planeteve janë komplet të ndryshme: Nga planetë pak më të mëdhenj se Toka, në gjigantë me madhësi disa herë më të madh se e Jupiterit, i cili vetë është 318 herë më i madh se planeti Tokë

“Këto vëzhgime i kanë certifikuar astronomëve ekzistencën e planetëve të shumtë dhe të ndryshëm që ndodhen rreth yjeve të largët duke na ndihmuar të shpjegojmë më mirë formimin e sistemit solar i cili fillimisht bazohej vetëm në sistemin tonë “ vëren Nuno Santos, i grupit të kërkuesve. Grupi ka paralajmëruar dhe zbulime të reja.



NGROHJA GLOBALE TEMPERATURAT DO TË RRIEN ME 4 GRADË NË VITET NË VIJIM

Një studimi i hartuar nga një prej organizmave kryesore që monitoron ndryshimin e klimës, Qendra Hadley në Britani, parashikon një rritje prej katër gradësh të temperaturës globale në vitet në vijim.

Të dhënat e studimi të ri për ndryshimet klimatike i bëri të ditura Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) në Shqipëri. Sipas studimit, një rritje e temperaturës mesatare deri në 2050 do të sjellë një rritje prej 10 gradë celcius, apo më shumë në disa zona si Arktiku dhe Afrika. Kjo do të thotë një rënie e thellë e shirave në disa zona, përmbytje në zona të tjera dhe shfarosje të gati mbi gjysmës së specieve dhe bimëve të botës.

Një arsye për këtë rritje të shpejtë është prova e re, për sa i takon pasojave të cikleve reaguese. Teksa rriten temperaturat, lëshohet më shumë dioksid karboni nga toka dhe oqeanet, ndaj edhe rritet efekti serë. Pas këtij studimi, shkencëtarët theksojnë se skenari i tyre për katastrofën nuk është i pashmangshëm, për sa kohë zvogëlohen emetimet që shkaktjnë efektin serë dhe që janë të shkaktuara nga njerëzit.



MINISTRI I PUNEVE TE JASHTME TURKE DAVUTOGLU VIZITON SHQIPERINE DHE THOTE: SIGURIA DHE STABILITETI I SHQIPERISE ESHTË SIGURI DHE STABILITET EDHE PER NE

Zv. Kryeministri dhe Ministri i Punëve të Jashtme z. Ilir Meta, priti në takim, Ministrin e Punëve të Jashtme të Turqisë, Prof. Dr. Ahmet Davutoglu, në kuadrin e një vizite zyrtare në Shqipëri.

Gjatë bisedimeve dy-palëshe të zhvilluara në Ministrinë e Punëve të Jashtme, z. Meta dhe homologu i tij turk z. Davutoglu konstatuan me kënaqësi se marrëdhëniet mes dy vendeve tona përbëjnë një model

të përsosur bashkëpunimi dhe partneriteti të vërtetë për vendet e rajonit dhe më gjerë.

Dy homologët, shprehën vullnetin e përbashkët për intensifikimin e mëtejshëm të bashkëpunimit politik, i cili do të vazhdojë me shkëmbime të tjera të rëndësishme gjatë këtij viti mes dy vendeve, sikurse është vizita në Shqipëri, në fillim të muajit dhjetor 2009, e një vend të rëndësishëm gjatë bisedimeve, zuri edhe thellimi i bashkëpunimit midis dy ministrive të jashtme si në nivelin bilateral, ashtu edhe në nivelin rajonal dhe atë ndërkombëtar, në veçanti në kuadër të NATO-s dhe të integritimit në Bashkimin Evropian.

Arritje e rëndësishme dhe konkrete e këtyre bisedimeve ishte vendimi i përbashkët për përfundimin sot, me shkëmbim notash, të marrëveshjes ndërmjet dy Qeverive respektive për heqjen pagesës së vizave për shtetasit shqiptarë e turq.

Z. Meta vlerësoi në veçanti dinamikën e re që kanë marrë shkëmbimet ekonomike e tregtare midis dy vendeve si dhe shumëfishimin, gjatë 4 viteve të fundit, të investimeve turke në Shqipëri. Ai gjithashtu, shprehu angazhimin e Qeverisë shqiptare për të forcuar bashkëpunimin veçanërisht në fushat e shëndetësisë, arsimit, kulturës, turizmit e transportit.

Z. Davutoglu, i cilësoi marrëdhëniet vëllazërore mes dy vendeve të përkryera dhe shprehu vullnetin e Qeverisë turke për të thelluar bashkëpunimin diplomatik dhe për të nxitur më tej investimet turke në Shqipëri, të cilat, sikurse u shpreh ai, janë në nivelin e rreth 1 miliard US dollarë.



PARLAMENTI SHQIPTAR SHTYRN PËR KOHË TË PACAKTUAR SEANCËN E RATIFIKIMIT TË MARRËVESHJES QEVERTARE MIDIS SHQIPËRISË DHE GREQISË PËR PËRCAKTIMIN E KUFIRIT UJOR MIDIS TYRE

Shpjegimi zyrtar për shtyrjen e saj ishte për çështje teknike - pakësimin e zhvillimit të seancave parlamentare, por zëvendëskryeministri dhe ministri i Jashtëm Ilir Meta tha se gjithshka bëhet për të bërë më shumë transparente këtë marrëveshje.

Korrespondenti i BBC-së në Tiranë thotë se vendimi për shtyrjen e seancës parlamentare duket se është marrë edhe për shkak të mos acarimit të mëtejshëm të situatës politike në vend, e cila mbetet e tensionuar pas zgjedhjeve parlamentare të 28 qershorit.

Që prej disa ditësh një grup partish opozitare, nga e majta dhe e djathta e spektrit politik shqiptar, tek të cilat ndihen doza jo të pakta nacionalizmi, kanë vendosur t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për të verifikuar kushtetutshmërinë e marrëveshjes.

Ato pretendojnë se nga përcaktimi i kufirit ujor midis Greqisë dhe Shqipërisë, kjo e fundit ka humbur 354.4 kilometra katrorë sipërfaqe ujore, por përfaqësuesit e qeverisë nga ana e tyre thonë se nuk është lëshuar asnjë centimetër sipërfaqe.

Marrëveshja u nënshkrua në muajin prill të këtij viti, me rastin e vizitës në Shqipëri të kryeministrit grek Karamanlis, por zërrat kundër saj u shtuan vetëm tani në prag të ratifikimit nga parlamenti shqiptar.

Marrëveshja, e miratuar më parë nga Komisioni parlamentar i Ligjeve, përcakton koordinatat e reja ujore mes Shqipë-



risë dhe Greqisë, pasi kufiri mes dy vendeve nuk ka qenë asnjëherë i përcaktuar.

Në të përcaktohet një kufi ndarës në masë të barabartë mes dy shteteve, 150 pika ndarëse në të gjithë sipërfaqen ujore.

Si shkas shërbeu publikimi në media i një studimi sipas të cilit përcaktimi i kufirit ka ndryshuar mjaftë nga pikat e njohura të referimit në përcaktimin e kufijve midis dy shteteve.

Debati rreth kësaj marrëveshjeje, përveçse teknik, pritet të shtrihet më tej pasi në opinion vlerësohen veçanërisht disa deklarata të zyrtarëve të lartë grekë se marrëveshja e arritur ishte e një rëndësie strategjike për Greqinë.

Në qendër të komenteve e analizave po shfaqet edhe çështja e kalimit në drejtim të Italisë e gajzjellësit nga Rusia "Rruga Jugore" i cili duket se përfundimisht ka shmangur Shqipërinë.

VENDIMI, MESUESIT TETE ORE NE PUNE ME DETYRIM

Mesuesit do te duhet te rrine ne shkolle, pavaresisht se kane perfunduar oret mesimore me nxenesit. Ky eshte vendimi me i fundit qe pritet te dale nga Ministria e Arsimit. Sipas ketij vendimi, mesuesit do te rrine ne shkolle aq sa te plotesojne 8 ore pune dhe jo me 6 ore mesimore, ashtu sikurse benin deri me sot. Ky fakt eshte konfirmuar gjate dites se djeshme nga ministri i Arsimit, Myqerem Tafaj i cili ka pohuar se pervec qendrimit ne pune, mesuesit do te duhet te kryejne edhe kurse per nxenesit.



ORËT

Nese deri dje nje mesues, me mbarimin e mesimit perfundonte punen, tashme kjo nuk do te ndodhe me. Ministria e Arsimit ka vendosur qe koha e punes se mesuesve, te jete si ne administrate, 8 oraresh. Pas mesimit ata jane te detyruar te zhvillojne kurse falas me nxenesit e tyre. "Mesuesit do te qendrojne ne pune edhe pasi te kene perfunduar orarin e mesimit. Kjo per te rritur cilesine e mesimdhenies. Kjo eshte nje nga strategjite me te mira te hartuara deri me tani", kane pohuar drejtuesit e Ministrise se Arsimit. Sipas tyre, pikesynimi i pare i ketij vendim eshte eliminimi i kurseve private. Organizimi i punes 8 oraresh per mesuesit do te behet nga vete shkollat. Dy here ne jave, cdo arsimtar ka te detyruar kryerjen e kurseve 2-oreshe me nxenesit. Ndersa ditet e tjera ai do te angazhohet per mbarevajtjen e veprimtarive te shkolles.

ORE SHITESH, POR JO RRRITJE RROGE

Pavaresisht se mesuesit do te punojne te pakten edhe dy apo 3 ore me shume ne dite, nuk do te kene rritje te pageses. Kjo per shkak se pagat e mesuesve jane te njejta me punonjesit e tjere te cilet punojne 8 ore. "Per punen shitesh pas mesimit, mesuesit nuk do te paguhen. Pagat e arsimtareve jane mjaft te mira dhe te llogaritura per 8 ore pune, jo 6 ore mesimi 45 minuteshe", ka pohuar zv/ministrja e Arsimit, Nora Malaj. Sipas saj, rritja e pages se mesuesve do te jete ajo qe eshte parashikuar gjate vitit, ashtu sikurse jane rritur edhe gjate ketyre viteve. Sot nje mesues merr mesatarisht 35 mije leke ne muaj, nderkohe po keto paga jane edhe per punonjesit e shendetesise, si mjeket apo infermieret.